



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:011253
Datë: 16.09.2021
Numri i dokumentit: 02181076

PKR.nr.24/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët Drilon Haraçia – kryetar i trupit gjykues, Manduhije Sylja dhe Myfera Hoxha – anëtare të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional Driton Sadiku, në lëndën penale ndaj të akuzuarit J. (Xh.) N. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (më tej KPRK-së), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, PP/II.nr.1648/18, të datës 23.11.2017, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor me datë 26.05.2021, 16.06.2021, 26.07.2021 dhe 17.08.2021 në prezencën e Prokurorit së Shtetit Ali Uka, të dëmtuarit U.Q. dhe të autorizuarës së tij, av.Zahide Gjonaj nga Prishtina, si dhe të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av.Muharrem Hadri nga Gjakova, i caktuar sipas detyrës zyrtare, **me datën 20.08.2021** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa **me datë 16.09.2021**, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

J. N. nga i ati Xh., e ëma H., e gjinisë B., data e lindjes . . . , në Gjakovë, tani me banim në rr. “. . .”, p.n., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, me profesion kamarier, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: . . .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 10.09.2017, rreth orës 21:30 minuta, në Gjakovë afër marketit “. . .”, konkretisht tek lokali i bastores sportive “. . .”, i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarit U.Q. nga Gjakova, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje lidhur me një borxh që ia ka pasur i akuzuari J. N. të dëmtuarit U.Q., ka ardhur deri tek mosmarrëveshje në mes tyre dhe janë përleshur fizikisht që të dy mes vete, ku i akuzuari është larguar dhe pas një kohe të shkurtër është kthyer dhe me një thikë - mjet i përshtatshëm për të shkaktuar lëndime të rënda trupore, të dëmtuarit i ka rënë dy herë, duke i shkaktuar plagë shpuese në regjionin nën shpatullën e djathtë dhe në kufirin e pjesës së poshtme të anës së majtë të kraharorit në pjesën ijore, ku është grumbulluar gjaku në zgavrën e djathtë të kraharorit, pas traumës së pësuar në torakostomin e kraharorit dhe nxjerrjes së rreth 200 mililitra gjak, këto dëmtime janë shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të mprehtë, me mekanizmin shpuese, të përshkruara nga plotësim ekspertiza e Dr.F. B. e datës 19.03.2018 dhe nga mendimi i grupit të ekspertëve, Dr.E. K., Dr.A. B. dhe Dr. N. K. të datës 21.01.2021 që si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore, për shkak të zhvillimit të Hemopneumothoraxit Traumatik (gjakderdhjes së ajrit të lirë në zgavrën e kraharorit).

- **Me çka ka kryer veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.3 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 38, 39, 40, 42, 69, 70, 79 dhe nenit 186 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.3 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIMIN ME BURGIM në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 14.09.2017 deri me datë 31.10.2017, të cilin dënim do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: U.Q. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari J. N. që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën mjeko - ligjore shumë prej njëzet (20) Euro, kompensimin e ekspertit mjeko-ligjore në seancë në shumë prej njëqind e pesëdhjetë (150) Euro dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga njëqind (100) Euro, si dhe shumë prej pesëdhjetë (50) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, konform neni 39 par.3, nënpar.3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e cila shumë duhet paguar në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/IL.nr.1648/17, të datës 23.11.2017, kundër të akuzuarit J. N. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par. 1.1 të KPRK-së. Me parashtrësën e datës 05.05.2018, Prokuroria Themelore në Gjakovë, pas marrjes së mendimit plotësues të ekspertizës mjeko-ligjore, të përpiluar nga Dr.F. B., të datës 16.03.2018, ka bërë rikualifikimin e veprës penale, nga vepra penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KPRK-së, në veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 të KPRK-së, për çka kjo çështje penale ka kaluar në kompetencë lëndore të Departamentit për Krime të Rënda.

Prokurori i shtetit Agron Matjani, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 27.12.2018, ka bërë plotësimin e dispozitivit të aktakuzës si dhe rikualifikimin e veprës penale, ashtu që dispozitivi duhet të jetë “se me datën 10.09.2017, rreth orës 21:30 minuta, në Gjakovë afër marketit “. . .”, konkretisht tek lokali i basotres sportive “. . .”, i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarit U.Q. nga Gjakova, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje lidhur me një borxh që i ka pasur i akuzuari J. N. të dëmtuarit U.Q., ka ardhur deri tek mosmarrëveshje në mes tyre dhe janë përlëshur fizikisht që të dy mes vete, ku i akuzuari është larguar dhe pas një kohe të shkurtër është kthyer dhe me një thikë - mjetë i përshtatshëm për të shkaktuar lëndime të rënda trupore, të dëmtuarit i ka ra dy herë, duke i shkaktuar plagë shpuese në regjionin nën shpatullën e djathtë dhe në kufirin e pjesës së poshtme të anës së majtë të kraharorit në pjesën ijore, ku është grumbulluar gjaku në zgavrën e djathtë të kraharorit, pas traumës së pësuar në torakostomi e kraharorit dhe nxjerrjes së rreth 200 mililitra gjak, këto dëmtime janë shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të mprehtë, me mekanizmin shpuese, që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore dhe janë të karakterit

të përkohshëm të shëndetit” Këso dore ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së.

Shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale ka filluar rishtazi në kuptim të nenit 311 par.1 të Kodit të Procedurës Penale Nr.04/L-123 (më tej KPP-së), pasi që gjatë shtyrjes së shqyrtimit gjyqësor ka ndryshuar përbërja e trupit gjykues, përkatësisht kryetari i trupit gjykues, gjyqtari Gëzim Pozhegu është pensionuar, ashtu që si kryetar i trupit gjykues, është caktuar gjyqtari Drilon Haraçia, ndërsa anëtarët e trupit kanë mbetur të njëjtat, gjyqtarët Manduhije Sylja dhe Myfera Hoxha.

I akuzuarit J. N., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet me akuzë.

Prokurori i Shtetit Ali Uka në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim dhe elaboruar në seancë ka deklaruar se; gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor verbal publik në çështjen penale të të akuzuarit J. N. nga Gjakova, ***i akuzuar për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 pika 1.3 të KPRK-së (duke i referuar Kodit penal i cili është ne fuqi, i cili është në favor të pandehurit)***, me pa mëdyshje nga provat materiale të administruara gjatë këtij shqyrtimit gjyqësor siç janë: raporti i hetuesit M. U. i datës 12.09.2017, raporti fillestar i incidentit me nr.2017-EA-1032 i datës 10.09.2017, raporti i hetuesit policor H. M. i datës 10.09.2017, raporti i oficerëve policor K. Th. dhe K. Sh. i datës 11.09.2017, raporti i oficerit policor A. B. i datës 11.09.2017, raporti tjetër i oficerit policor A. R. i datës 10.09.2017, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës së njëjtë, fletë lëshimi nga QKUK-ja, Klinika e kirurgjisë torakale me nr.886, për të dëmtuarin U.Q. e lëshuar me datë 14.09.2017, raporti i Emergjencës i SR “Isa Grezda” në Gjakovë për të dëmtuarin U.Q. i datës 10.09.2017, akt ekspertimi mjeko-ligjor i përpiluar nga Dr.F. B. i datës 05.10.2017, plotësim mendimi i përpiluar nga eksperti i njëjti i datës 19.03.2018, ekspertiza mjeko-ligjore për të dëmtuarin U.Q. e përpiluar nga ekspertët Dr.E. K. dhe Dr.N. K. që të dy kirurg torakal me datë 21.01.2019, ekspertiza tjetër plotësuese e përpiluar nga ekspertët mjeko-ligjore, Dr.E. K., Dr.A. B. dhe Dr.N. K., me datë 11.01.2021, si dhe nga provat formale siç janë dëshmia e dëshmitarit-të dëmtuarit U.Q., dëshmia e dëshmitarëve B. L. dh L. R., në tërësi u vërtetua se në veprimet e të pandehurit J. N. qëndrojnë të gjitha elementet qenësore të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 pika 3.1. lidhur me par.1 pika 1.3. të KPRK-së. I dëmtuari U.Q. pos tjerash deklaroi se ditën kritike ka shkuar në lokal-in-bastoren sportive “. . .” në Gjakovë dhe ndërsa ishte i ulur aty në terrasë të lokalit, aty ka hyrë J.i i cili pas pak doli nga bastorja aty në teras, ia kërkova disa të holla të cilat ia kisha dhënë hua më herët dhe atë diku 30-40 euro, ai i është përgjigjur se do të ia kthejë ato të holla por njëkohësisht i ka thënë që të mos të ia kërkojë më ngase nuk e ka në plan me mi dhënë, në ato momente është ngritur në këmbë meqenëse ishte i ulur, “B.” i cili ndërhyri, ndërsa J.i e ka shtyrë dhe i ka thënë “a po më pret këtu” ia ka kthyer se “unë nuk të kam borxh ty por ti me ke borxh mua”, J.i pas këtij momenti ka marrë vrapin ka shkuar në shtëpinë apo banesën e tij dhe pas rreth 3-5 minutave derisa është larguar prej vendit ku ishte i ulur ka dal pas “. . .” në parking për ta marr një taksì e për të shkuar në shtëpi, ka ardhur J.i së bashku me vëllain e tij dhe një person tjetër dhe menjëherë ia ka shkaktuar lëndimet e rënda e që është konstatuar edhe në bazë të ekspertizës e nga të cilat lëndime vuan akoma. Pas atyre goditjeve me thikë “B.” më ka kap për krahu dhe kemi hip në një taksì afër Gjykatës dhe kam shkuar në emergjencën e Spitalit në Gjakovë. Tutje ka deklaruar se J.i e ka goditur me thikë dy herë në shpinë në momentin kur ishte duke u përleshur me E.. Po ashtu kemi vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarëve J. dhe B. L. të cilave dëshmi iu kemi ofruar besim të plotë provues dhe njëkohësisht kemi vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitares përkatësisht ekspertizës mjeko-ligjore, te Dr.E. K. e cila në këtë shqyrtim gjyqësor deklaroi se ekspertizën mjeko-ligjore për të dëmtuarin U.Q. të përpiluar me datë 11.01.2021, e cila pos tjerash deklaroi se mënyra se si

ka ardhur deri te konstatimi se 5 % tek i dëmtuari kemi të bëjmë me zvogëlimin e aktivitetit jetësor për punë mirëpo pas sanimit të lëndimit, nuk mbesin pasoja në aktivitet e përgjithshme jetësore më tepër se 5 %, mirëpo zvogëlimi i aktivitetit prej 5 % është një përqindje relativisht e vogël por kuptohet që e përcjellë tërë jetën. Andaj duke u mbështetur në të gjitha këto prova si ato formale e po ashtu edhe materiale, të gjitha të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor deklarojë se mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të dhënë gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor ashtu që i propozojmë Gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor për këtë vepër penale, ta gjykojë sipas ligjit dhe njëkohësisht ta obligojë në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale.

Përfaqësuesja e autorizuar e palës së dëmtuar U.Q., av.Zahide Gjonaj, në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim dhe elaboruar në seancë ka deklaruar se; në këtë çështje penalo juridike janë mbajtur një numër i konsiderueshëm i seancave gjyqësore dhe mbi bazën e administrimit të provave në mënyrë të padyshimtë iu vërtetua teza e aktakuzës së prokurorisë së shtetit se i akuzuari J. N. ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 pika 3.1. lidhur me par.1 të KPRK-së. E mbështesim fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, i cili në mënyrë të detajuar dhe të hollësishme trupit gjykues ia prezantoi fjalën e tij përfundimtare mbi bazën e së cilës vërtetohet qartë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Konsiderojmë se me rastin e administrimit të provave, është vërtetuar bindshëm se i dëmtuari U. ka qenë viktimë e veprës penale të lartcekur e cila është kryer me paramendim, me dashje nga këtu i akuzuari, meqenëse është provuar se në veprimet e të dëmtuarit nuk ka pasur asnjë veprim, me të cilin do të provokonte apo do ta nxiste të akuzuarin që të kryej veprën penale lëndim i rëndë trupor. Nuk mund të qëndrojë mbrojtja e të akuzuarit i cili ka për qëllim shmangien nga përgjegjësia penale, mbrojtje e cila është e pa synqertë, e njëanshme dhe subjektive dhe lus gjykatën që mos të ia fal besimin deklaratës-mbrojtjes së tij. Nga ekspertiza e cila gjendet në shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e ndërmarra dhe pasojat e të njëjtave, andaj në rastin konkret kemi të bëjmë me rrethana posaçërisht rënduese. Megjithatë, i dëmtuari U. dhe unë si përfaqësues, nuk jemi të kënaqur me kualifikimin e veprës penale lëndim i rëndë trupor, por ne mendojmë se kjo vepër penale ishte dashtë të kualifikohet si vrasje në tentativë. Nga se duke u bazuar në rrethanat e çështjes dhe provave të administruara në procedurën e provave rezulton qartë se në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale vrasje në tentativë. Ne si palë e dëmtuar, kërkojmë nga trupi gjykues që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim maksimal në pajtim me KPRK-në, për veprën penale për të cilën ngarkohet me aktakuzë, meqenëse në rastin konkret nuk ka asnjë prove lehtësuese në anën e të akuzuarit, kurse si rrethanë rënduese gjykata duhet të merr moshën e të dëmtuarit, pasojat e veprës, dashjen e të akuzuarit i cili me çdo kusht ka dashtë ta privojë nga jeta tani të dëmtuarin U.Q.. Nga të dhënat e lartcekura në mënyrë të padyshimtë u vërtetua se i akuzuari është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, andaj kërkojmë nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit

Mbrojtësi i të akuzuarit J. N., av.Muharrem Hadri, në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim dhe të elaboruar në seancë ka deklaruar se: konsiderojë se me administrimin e provave, sidomos me dëgjimin e dëshmitarëve në përgjithësi si dhe me vet mbrojtjen e të akuzuarit, është vërtetuar se aktakuza e ngritur ndaj të akuzuarit J. N., është në tërësi e pabazuar. Në rastin konkret në mënyrë shumë bindëse është vërtetu fakti se motivi i këtij rasti kishte filluar nga tani i dëmtuari U.Q., i cili në vendin e caktuar në bastoren e quajtur “. . .”, në Gjakovë përderisa ishte në shoqëri me B. B., me pseudonimin “B.”, duke konsumuar alkool – birra, që ishte nën ndikim të alkoolit, përderisa i akuzuari J. N. kishte shkuar për të dorëzuar një tiketë në bastore, e fton të akuzuarin J. në mënyrë urdhëruese “paja ko dhe pse po shikon J.”, U. ia kërkon 50 euro duke i thënë se ia ka borxh, ashtu që ky i përgjigjet se nuk i kom borxh se këto në një kohë me pare mi ki fal, por në vazhdim duke e vërejtur se është nën ndikim të alkoolit i thotë se sot nuk i kom por kur t'i bojë do t'i japi, mirëpo U. ishte këmbëngulës që në çdo mënyrë J. i me ia dhënë paratë që ia kërkonte ashtu

që në të njëjtin rast, e godet me shuplak apo grusht dhe me bashkëveprimin e shoqëruesit të tij e rrëzojnë në tokë duke e goditur në vazhdim disa herë në fytyrë dhe pjesë tjera të trupit përderisa ishte i shtrirë në tokë dhe përmbi e kishte U. dhe shoqëruesin e tij, ashtu që pas ndërhyrjes së dëshmitarëve arrin që të shmanget nga një moment, mirëpo U. që nga fillimi e kishte fyer dhe sharë në mënyrën më të vrazhdë, në nënë, motër, familje dhe duke i thënë do të vras, etj. Ashtu që i akuzuari është dal në shorce të shkurta, me papuqe plazhi, ishte ik, por pas 3-4 minutave e vëren se i kishte rënë telefoni dhe kthehet për ta marrë në vendin e theksuar, te shitorja që mbaron çelësa të ndryshëm, ashtu që . dhe shoqëruesi i tij e kishin blloku që mos të mund të ik dhe U. kishte në dorë një thikë që e përshkruan i akuzuari me ngjyrë të kuqe dhe shpjegime tjera si në procesverbalin e seancës së datës 26.07.2021, po ashtu thikë kishte në dorë edhe i ashtu quajtur B. pra B. B. nga Shqipëria, kur U. ka tentu që ta godet me thikë ka arrit që U. të ia tërheq thikën nga dora dhe këtë në bazë të aftësisë së tij, se theksojë se ka qenë karatist dhe posedon brezin e zi të karates dhe ka arrit që duke u mbrojtur dhe gjithnjë duke e përdorë U. në formë mbrojtje dhe sjellë nga ana e kundërt e B. e ka godit me thikën që kishte vet U. Konsiderojë se prokurori nuk i ka analizuar në përpikëri të gjitha rrethanat e rastit se siç theksove më latë, tani i dëmtuari U. e fillojë vetë këtë rast, duke e goditur disa herë të akuzuarin e shtrirë për tokë, duke tentuar që ta godas edhe me tej por i akuzuari kishte ik, dhe ky fakt nuk ishte kontestues se të gjithë dëshmitarët theksuan se J. është ik mbi 100 metra largësi në drejtim të rrugës kryesore që shkon në drejtim të stacionit të autobusëve, çka do të thotë se si e trajton të dëmtuar personin që fillon vet rastin në fillim me sharje dhe e godet dhe rrëzon për tokë dhe nuk merr veprime adekuate, se çka në fakt duhet analizuar në tërësi konsiderojë se është detyrë ligjore e prokurorit që në bazë të provave duhet vepruar që t'i trajtojë në tërësi të gjitha veprimet si nga aj që e trajton të dëmtuar dhe në anën tjetër të akuzuarin. Në këtë rast, nga ajo që është vërtetu në këtë çështje është rast i pa kontestuar se i akuzuari kishte vepruar në mbrojtje të tij në mënyrë të mbrojtjes që veprimi i tillë në kuptim të nenit 12 të Kodit Penal paraqet mbrojtje të nevojshme ashtu që pika 1. Vepra e kryer në mbrojtje të nevojshme nuk është vepër penale, pika 2. Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetes apo personit tjetër, etj. Përfundon citati. Me këtë që e theksuam dhe duke u bazuar në të gjitha faktet dhe provat që ky rast është në mënyrë jo kontestuese si i akuzuari nuk është kryes i veprës penale që i vihet në barrë. Sa i përket kualifikimit të veprës penale meqenëse i njëjti ka vepruar në mbrojtje të nevojshme e konsiderojë irrelevant çështjen e kualifikimit juridik të veprës penale e sidomos se nuk është vërtetu në mënyrë të plotë dhe të drejtë çështja e administrimit të provave në këtë variant, nuk u leju që të bëhet super ekspertizë apo të dëgjohen edhe dy mjekët tjerë dhe në fund konsiderojë se mos lejimi i administrimit të provave paraqet shkelje esenciale të dispozitave procedurale. Por siç theksuam më lartë i akuzuari në veprimet e tija nuk është kryes i veprës penale në fjalë dhe në mënyrë shumë bindëse u vërtetu fakti se kurrë më parë në jetën e tij me askënd nuk kishte pas kurrfarë konflikti as para rastit edhe pas këtij rasti, pra me veprimet dhe kontributin e të dëmtuarit ai trajtohet në gjykatë pa fajin e tij, andaj në bazë të të gjitha fakteve konsiderojë se vet prokurori është dashtë që me heq dorë nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit. Mirëpo pasi që nuk jam në dijeni të fjalës përfundimtare të prokurorit, gjykatës i propozojë që të akuzuarin J. ta liron nga akuza se i njëjti ka vepruar në mbrojtje të nevojshme dhe nuk paraqet vepër penale. Po ashtu shtojë se siç kam theksuar në faqen e 2-të të fjalës sime përfundimtare e që ka të bëjë me fjalën përfundimtare të theksuar nga ana e prokurorit, konsiderojë se në asnjë mënyrë nuk është trajtuar çështja e motivit dhe fillimit dhe dashjes, kontributit të të dëmtuarit se si ka ndodhur dhe sot para trupit gjykues gjendet i mbrojturi im, i cili në asnjë mënyrë me asnjë veprim të tij nuk e ka dëshiruar një rast të tillë, rrethanën, motivit dhe kontributin e të dëmtuarit që e ka ndërmarrë në bashkëveprim me shoqëruesin e tij, B. B. me nofken B. kanë filluar ta rrahin, ta shtrojnë për tokë, ta godasin disa herë duke e poshtëruar në formën më të rëndë të mundshme, që duhet shtruar pyetja, si prokurori i çështjes në asnjë formë nuk e prezanton rastin si të tillë, por nga ajo që dëgjova si dhe në të njëjtnë të formës së shkruar përdoren edhe të theksuara të cilat fare nuk janë administruar gjatë shqyrtimit

gjyqësor. Nuk qëndron asnjë rrethanë dhe fakt që gjykata duhet ta mbështetë aktakuzën e pabazuar, i mbrojturi im ka vepruar në mbrojtje të nevojshme siç është përshkruar në fjalën time përfundimtare të formës së shkruar, e në mënyrë decisive e përcakton dispozita e nenit 12 e KPK-së. Çka do të thotë se i mbrojturi im nuk ka pasur tjetër mundësi të shmangies së sulmit të atëçastshëm. Sa i përket të autorizuarit të palës së dëmtuar siç aludon në pasuset e fundit të fjalës përfundimtare të shkruar që vlen të theksohet që duhet ta citoj, që ne si palë e dëmtuar kërkojmë nga trupi gjykues që ta akuzuarit t'i shqiptohet dënim maksimal në pajtim me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, mirëpo përfaqësueses së palës së dëmtuar nuk i takon propozimi për ndonjë shqiptim maksimal të dënimit apo çfarëdo tjetër pos asaj të bashkëngjitjes së ndjekjes penale, kjo është pjesë e prokurorisë e jo të përfaqësuesit të dëmtuarit. Gjykatës i propozoj që sa i përket këtyre pretendimeve të cilat në tërësi janë kontradiktore me të gjitha provat e administruara në shqyrtimet gjyqësor paraprake çoftë nga dëgjimi i dëshmitarëve dhe provave tjera. Sa i përket pretendimit të theksuar në fjalën time përfundimtare se nuk është mundësuar në përpikëri administrimi i provave sidomos në propozimin për super ekspertizë apo me dëgjimin e dy mjekëve tjetër ekspert siç në ekspertizën në formë të shkruar në shkresat e lëndës. Unë konsideroj se Kryetari i trupit gjykues dhe trupi gjykues do t'i shqyrtojnë në përpikëri të gjitha shkresat e lëndës dhe një rrethanë posaçërisht se i mbrojturi im asnjëherë më parë nuk ka ra në kolizion me normat ligjore, për herë të parë me vet kontributin e të dëmtuarit sot gjendet para trupit gjykues në tërësi i pafajshëm, nuk është kryes i veprës penale që i vëhet në barrë, meqenëse siç theksova më lartë ka vepruar në mbrojtje të nevojshme dhe këtë propozim e konsideroj si të arsyeshëm dhe të bindshëm dhe shpresoj që trupi gjykues do të veprojë në mënyrë meritore.

I akuzuari J. N., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam se çka të shtojë.

2. Provat e administruara gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuari J. N., nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka administruar këto prova: ka dëgjuar të dëmtuarin në cilësi të dëshmitarit U.Q., ekspertin mjeko-ligjore Dr.E. K., dëshmitarët J. L., B. L. dhe L. R., si dhe ka administruar provat materiale që janë propozuar nga palët dhe atë: shikimi i 2 raporteve të hetuesit M. U., të datës 12.09.2017; raportit fillestar i incidentit me numër të rastit 2017-EA-1032, i datës 10.09.2017; raportit i hetuesit H. M., i datës 10.09.2017 së bashku me flash-raportin e datës 10.09.2017; raportit i oficerit K. Th. dhe K. Sh., i datës 11.09.2017; raportit i oficerit A. B., i datës 11.09.2017; raportit i oficerit A. R. i datës 10.09.2017; raportit i këqyrjes së vendit të ngjarje të përpiluar nga Policia e Kosovës me numër të rastit 2017-EA-1032, i datës 10.09.2017 së bashku me foto albumin e përpiluar nga kimteknika; raportit fletë-lëshimi i lëshuar nga QKUK-ja, Klinika e Kirurgjisë Torakale me numër 6886, në emër të dëmtuarit U.Q., me datë të lëshimit 14.09.2017 së bashku me dy dëftesë - pagesa; raportit i emergjencës i lëshuar nga Spitali Rajona; "Isa Grezda" në Gjakovë, në emër të dëmtuarit U.Q., i datës 10.09.2017; akt ekspertimit mjeko-ligjor, i përpiluar me datën 05.10.2017, nga Dr.F. B.; akt ekspektimi mjeko-ligjor (plotësim mendimi), i përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Dr. F. B., të datës 19.03.2018; akt ekspertizën mjeko-ligjore për të dëmtuarin U.Q. të përpiluar nga ekspertët vlerësues, Dr.E.K.-kirurge torakale dhe Dr.N. K. – kirurg torakal, të datës 21.01.2019 dhe Ekspertizën plotësuese të përpiluar nga ekspertët mjeko ligjor Dr. E. K., Dr.A. B. dhe Dr.N. K., të datës 11.01.2021, si dhe ka dëgjuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit J. N..

2.1. Deklarata e të dëmtuarit e dhënë në cilësi të dëshmitarit.

2.1.1 Dëshmitari - i dëmtuari **U.Q.**, gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se: mbes pranë deklaratës së dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.02.2019, i përmbahem asaj deklaratë dhe se nuk kam çka të shtoj tjetër. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit, av.Muharrem Hadri, ka shtuar se ka kaluar kohë e gjatë prej kur ka ndodhur rasti dhe nuk më kujtohet ora kur ka ndodh. Kam qenë i shoqëruar me B. B., në tavolinë i ulur. Unë nuk kam konsumuar pije alkoolike-birra atë ditë, kam pasur espresso duke pirë, ndërsa B. B.ka qenë duke pirë birra. Nuk më kujtohet sa kohë kam qëndruar në atë lokal. Mbrojtësi i të akuzuarit, e pyet të dëmtuarin se në seancën e datës 22.02.2019, keni deklaruar se “në lokal kam qëndruar 40-45 minuta dhe ka mundësi që kam pirë tri birra të vogla në atë lokal” (faqja 4 pasusi i parafundit dhe i fundit), a është e vërtetë kjo. Dëshmitari është përgjigjur se vet fjala që kam cekur atëherë “ka mundësi”, ka mundësi të ketë kaluar shumë kohe dhe tani nuk më kujtohet. Ka shtuar se siç e ceka më herët unë kam dhënë një deklaratë me datë 22.02.2019 dhe mbes në tërësi pranë asaj, sot nuk jam në gjendje të deklarohej edhe njëherë lidhur me çështjen, pasi që jam i traumatizuar dhe jam duke shkuar te psikiatri. Ka shtuar se deri tek konflikti ka ardhur pasi që ia kam kërkuar borxhin prej tridhjetë (30) Euro. Nuk më kujtohet se a me ka thënë se t’i jap, a nuk t’i jap, apo s’du me t’i jap kurrë. Nuk më kujtohet se a e kam goditur J.in në ndonjë mënyrë. Duke u përgjigjur në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues ka shtuar se thikën nuk e kam parë, pasi që më ka rënë pas shpine dhe kanë qenë tre persona, andaj nuk mund ta bëjë përshkrimin e thikës, edhe vëllai i të akuzuarit më ka sulmuar dhe nuk e di se cili më ka rënë thikë. Në deklaratën e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.02.2019, pranë së cilës deklaratë i dëmtuari ka deklaruar se mbetet në tërësi, ka deklaruar se: të akuzuarin J. N. e njoh se ka punuar në bastore në kurriz e cila quhet “. . .”. Më parë nuk kam pasur mosmarrëveshje me të. Bastorja “. . .”, gjendet në krahun e djathtë të tunelit, te kafja e . . . Ditën kritike kam qenë në lokal të bastores. Zakonisht kam qenë ka ora 20:00 – 20:30/h. Kam qenë i ulur në tavolinë me një person, të cilit nuk ia kam ditur emrin, i njëjti ka qëndruar në bastore rregullisht dhe ka luajtur, i njëjti thirrej me pseudonimin “B.”, të cilin e kam gjetur aty, aj me ka thënë eja ulu dhe jam ulur me të. Kam shkuar me luft bastore. Aty nuk kishte asnjëlloj pije, aty nuk kam pi asgjë. Bishën e kam parë në ora 20:30/h të mbrëmjes. Ndërkohë sa isha ulur në bastore, vjen personi J. N. më përshëndeti dhe e përshëndeta, siç përshëndeteshim përpara. Pasi kam hyrë në bastore unë, ka hyrë J.i, i njëjti vjen rastësisht, nuk kam kontaktuar me të në telefon. Pasi hyri brenda J.i, derisa isha ulur në teras, çka ka bo brenda J.i nuk e di, por kur doli nga bastorja, unë i kërkova disa të holla të cilat ia kisha dhënë hua më herët, nuk ishte shumë e madhe e parave, nuk më kujtohet saktësisht shuma, se kemi qenë pra tri jave po me të njëjtin person në muzikë dhe ia kam dhënë dikuan tridhjetë (30) – (katërdhjetë) 40 Euro, ai më tha që t’i kthejë këto të holla, ia kërkova pasi kisha humbur në bastore dhe më tha “mos mi kërkoi më, se unë nuk e kam në plan me t’i jap”, kështu mu ka përgjigjur, kurse unë insistova të ia kërkojë borxhin, u ngrita në këmbë se isha i ulur dhe u ngrit ai personi që isha ulur me të “B.” më hyri ndërmjet, që mos të ngatërrohem me probleme, kurse J.i më shtyu dhe më tha me fjalën “a po më pret qitu”, pastaj unë i thashë se unë nuk të kam borxh ty, po ti më ke borxh mu, J.i mori vrapin duke shkuar në banesë apo në shtëpinë e vet, kur pas 3-5 minutave derisa unë u largova prej vendit ku isha ulur dhe dola pas “. . .it”, në parking, për ta marrë një taksì apo automjet për të shkuar në shtëpi, vjen J.i me vëllain e vet po ashtu me një shok, edhe vinte me thikë të cilën ai ka shkuar me qëllim të caktuar dhe e ka marrë tek shtëpia dhe më ka shkaktuar lëndime të rënda të cilat janë konstatuar në ekspertizë, prej të cila lëndimeve unë kam dhimbje dhe vuaj shumë prej lëndimeve. Kur ai më goditi me thikë isha në parkingun e “. . .it”. Derisa ka ardhur J.i kam qëndruar në parkingun e “. . .” maksimumi 5 minuta, nuk kanë qenë 10 minuta. Unë desha me ik prej vendi, ose me gjete taksì ose ndonjë koleg apo ndonjë të njofshëm, se aty shkojnë katundarët e mi me ble harxh, por nuk ke fati jam. Pas goditjeve që mora, nuk kam qëndruar në këmbë, B. më ka kap për krahu dhe kemi ardhur para gjykatës, kemi hip në një taksì dhe kemi shkuar në spitali, në emergjencë në Gjakovë. Spitali i Gjakovës më ka dërguar në QKUK-Prishtinë, ku kam qëndruar pesë ditë radhazi në kujdes intensiv. Ka shtuar se E. është vëllai i J.it, i cili ka sjell në mua dhe ka pas një çekiç, me të më ka rënë në dërrasë të gjoksit, në ato momente

derisa isha duke u përleshur me E., J.i më ka goditur me thikë në shpinë dy herë. Kur më ka kërkuar borxhin J.i, nuk më ka treguar se për çka po i nevojiten dhe nuk e di se pse i ka marr. Para rastit kemi ndejt me J.in, kur i njëjti ka punuar në bastore “. . .”, me pronar F.Z., unë kam fituar një bastore, ia kam fal (pesëdhjetë) 50 €, J.it. Duke u përgjigj në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit, av. Muharrem Hadri, ka deklaruar se ditën kritike, në orët e vona të mbrëmjes, kam qenë më herët në lokalin kafja e . . . , para orës 20:00/h, sa më kujtohet aty kam qëndruar 40-50/min., ka mundësi që kam pirë tre birra të vogla në atë lokal. Ka shtuar se duke filluar në bazë të fakteve kur ka ndodhur rasti i therjes dhe i ngjarjes, J.i ka qëndruar në bastore as pesë minuta kur ka ardhur dhe menjëherë ka shkuar në shtëpi për ta marrë thikën. Kur ka ardhur J.i unë kam qenë jashtë i ulur me peronin B. dhe kur ka dalur J.i nga lokali – bastorja unë e kam pyetur, se a ki diçka mem dhënë (borxhin që ma kishte më herët, 2-3 javë para ditës kritike) thash se po du me lujt. Me tej i dëmtuari ka sqaruar se njëherë ia kam falur pesëdhjetë (50) Euro, J.it, kur ka qenë duke punuar në bastore, kurse ky rasti që ia kam dhënë hua ka qenë shuma tridhjetë (30) – katërdhjetë (40) Euro, mi ka lyp hua. J.i më ka thënë se nuk do t'i jap kurrë paratë. Nuk më kujtohet që e kam goditur me shuplaka, grushte dhe se e kam shtrirë për tokë J.in. Unë nuk e di që kanë ndërhy J.i dhe punëtori i bastores, përveç personit me emrin “B.”, i cili ka hyr në mes nesh, me sa e di unë dhe sa më kujtohet ai na ka nda, ka hy në mes të dyve, unë edhe sot deklaroi se ka mundësi që jemi shty. Sa mua më kujtohet, ka qenë prezent veç B. dhe na ka nda, aty nuk ka pasur përleshje të madhe, pasi që J.i është larguar menjëherë. Prapë po e cekim se nuk më kujtohet që i kam ra. Kur kam shkuar në SHSKUK, në ekzaminimin e fundit, aty kanë qenë katër mjek, mjekja kryesore E., veç ajo më ka pyetur. Me dëshmitarin B. B.“B.”, njihem qe tre-katër muaj, nuk më kujtohet në sa ora jam takuar me të, kur kemi filluar me pi. Ka mundësi që jemi takuar në ora 17:00 me . . . dhe kemi pi te kafja e . . . , e jo në bastore.

2.2 Deklaratat e dëshmitarëve

2.2.1 Dëshmitari – **J. L.**, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: mbes pranë deklaratës së dhënë në prokurori dhe polici. Është e vërtetë që kam dhënë deklaratë me datë 20.03.2019 në këtë gjykatë, ajo çka kam thënë është e vërtetë, e kam parë me sytë e mi. Nuk kam çka të shtojë përveç asaj çka kam deklaruar më herët, pasi ajo ka zgjatur pesë minuta. Duke u përgjigj ne pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit, av. Muharrem Hadri, ka shtuar se më kujtohen deklaratat e dhënë me datë 20.03.2019 para trupit gjykues, me kujtohet se i pandehuri ka bërë vërejtje se kanë qenë më shumë persona në lokal, të cilët gjykata i ka thirr si dëshmitar, ndërsa një tjetër nuk e kanë parë të arsyeshme me e thirr. U. me shoqëruesin e tij nga Shqipëria, kanë qëndruar në lokal 2 orë e 30 minuta, të tunel, në tavolinën para lokalit. Unë kam qenë brenda në lokal dhe nuk e di se sa kanë konsumuar. Nuk e kam parë momentin e parë kur ka filluar konflikti, pasi që kam qenë në lokal brenda i kthyer me shpinë duke e parë televizionin dhe kur kam dëgjuar zhurmën e gotës që është thyer, kam dal jashtë dhe i kam parë të kacafytur dhe i kam thënë atij shoqëruesit kape ti tëndin dhe kanë ndërhy disa vetë dhe i kanë nda, njëri me emrin L. R. dhe një tjetër. Janë grushtuar në këmbë mes veti, i cili ka zgjatur 1-2 minuta dhe i kemi ndarë. Shton se rastin e therjes me thikë nuk e kam parë, pasi kam qenë në shtëpi duke ngrënë bukë dhe jam njoftuar prej pronarit të firmës atë ditë, më ka thënë dil e hape lokalin se kanë ardhur dy patrulla të policisë. Në deklaratën e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 20.03.2019, pranë së cilës deklarata dëshmitari J. L. ka mbetur në tërësi, ka deklaruar se; ditën kritike unë kam qenë në bastoren e cila gjendet afër ish Drejtorisë së Urbanizmit (afër kafes së . . .), nuk kam qenë duke punuar si punëtor, djali ka punuar aty. Të akuzuarin e njoh si figurë, edhe të dëmtuarin e njoh si figurë, e kam parë më tepër ndoshta. Natën kritike në bastore ka qenë djali i cili ishte para shankut, unë kam qenë te dera, në lokal ka qenë edhe i akuzuari, i cili ishte ulur në tavolinë duke mbushur tiketën, në teras ka qenë i dëmtuari i ulur në tavolinë me shokë. Në lokal nuk shërbejmë pije alkoolike, pijet i porosisin në lokalin afër, te kafja e . . . I dëmtuari ukë ka qenë me shokun e vet duke pirë, nuk e di a ka qenë duke pirë kafe, birrë apo laçin. Pastaj

J.i është ngritur nga tavolina dhe ka dal jashtë dhe kam dëgjuar krismën e një shihe të thyer, unë mendova se mos është thyer xhami, kam dal jashtë i kam parë duke i ndare të akuzuarin dhe të dëmtuarin. Pas ndarjes, U. e kam pa tek shkallët të cilat janë në krahun nga parkingu i V., kurse J.in e kam pa në afërsi të bastorës. Në ballafaqimin që i bënë prokurori i shtetit me deklaratën e dhënë në polici me datë 10.09.2017, faqe 1, ku dëshmitari ka deklaruar se “dy persona që kanë qenë jashtë pastaj e kanë thirr personin që ka qenë brenda dhe pasi që ka dal jashtë ky i fundit, kam dëgjuar disa britma”, a është e vërtetë kjo çka ke thënë. Dëshmitari ka deklaruar, po, është e vërtetë se kur është thyer shishja ma ka tërhequr vërejtjen dhe kur kam dal jashtë i kam pa duke i ndarë. Pasi u larguan nga aty, unë e fshina vendin dhe e mbylla lokalin. Gjatë kohës sa isha duke e pastruar lokalin, u kthye J.i në atë moment kur isha duke e mbyllur lokalin dhe në atë moment ka thënë “hajdi qetash një nga një”, jashtë lokalit nuk ka ndriçim, por në atë koment e kam dëgjuar edhe shokun e ., me të cilin ishte duke pirë se ka thënë “a edhe thikë paske”, me e pa, nuk e kam pa se a ka pas në dorë thikë. Atëherë e kam mbyll lokalin dhe kam vazhduar me djalin në shtëpi, duke ecur më larg nga lokali i L., rreth vendit ku shiten telefonat, më nuk kemi pa asgjë, vetëm kur na ka thirrre policia, jemi kon duke ngrënë bukë, na ka thirr policia me e hap lokalin. Kur u kthye J.i, U. ka qenë tek shkallët. J.i nuk u largua nga vendi i ngjarjes pasi që u ndanë, aty afër kanë qenë të dy palët. U. ka qenë me shoqëruesin e vet aty. Aty nuk ka pasur lëndime, konflikti ka zgjatur një minutë, se i kanë ndarë njerëzit, çka ka ndodhur mandej unë nuk e di. Kanë ndodhur dy ngjarje, e para te tavolina kur kam dëgjuar krismën, e dyta kur ka thënë këtu i akuzuari “hajdi një nga një”, 3-5 minuta pasi që është thyer gota, nuk e di saktësisht. Pastrimi i lokalit ka ndodhur në mes dy ngjarjeve, ku e kam hedhë bërlllokun mbas ndërtesës ku gjendet shoqata e pensionistëve, pasi që kam gjuajtur mbeturinat e kam dëgjuar kur ka thënë “hajdi një nga një”. Ka shtuar se kur ka dal J.i jashtë nuk e di se kush e ka thirr, U. apo shoqëruesi i U.. Kur është dal J.i jashtë unë i kam pa tu u nda, veç tu u nda, te lagjes ishin duke i nda, vëllai i shoqëruesit të U. dhe kanë qenë edhe 2-3 të lagjes. Në atë moment është thyer një shishe e birrës Peja, e vogël, nuk e kam par kush e ka thyer shishe. Unë nuk kam vërejtur duke u kacafytur apo ndonjë sulm fizik drejtpërdrejtë, vetëm kom pa kur vëllai i shoqëruesit tërhiqte U.. Në bastore përveç meje dhe djalit tim, kanë mujt me qenë të lagjes 2-3 veta, djali i madh i taksistit, V., vëllai i shoqëruesit, është njëri punon në shoqatë të sigurimeve, L. R.. Përveç këtyre nuk më kujtohet dikush tjetër. Shoqëruesit nuk ia di emrin, por vëllain e shoqëruesit e di që e thirrin “. . .” dhe më duke se punon në parking, saktësisht nuk e di, me të dëgjuar po tregoj.

2.2.2 Dëshmitari – **B. L.**, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: më kujtohet që kam dhënë deklaratë me datë 22.02.2019 pranë kësaj gjykatë, qëndroi pranë kësaj deklaratë, nuk kam diçka për të shtuar. Ka deklaruar se të akuzuarin J., nuk e kam njohur para rastit. Të dëmtuarin U. e kam njohur vetëm si figurë, jo shumë mirë. Ka shtuar se unë i kam parë duke u përleshur jashtë dyqanit, unë kam qenë brenda në dyqan, i akuzuari J. ka qenë në tokë, ndërsa U. ka qenë mbi të, pastaj i kemi ndarë dhe janë larguar, pastaj i kam pastruar gastaret e thyera dhe e kam mbyll lokalin dhe kam shkuar në shtëpi. Nuk më kujtohet se sa kohë ka qenë më parë U.a përpara lokalit, mirëpo 1 orë e 30 minuta, ka qenë i shoqëruar me një person tjetër të cilin nuk e njoh, kanë qenë duke pirë birra. Këto pije i kanë porositur në lokalin aty afër. Nuk kam mundur me e vërejt se sa birra kanë konsumuar brenda kohës sa kanë qëndruar aty. Më lart e shpjegova se si e kam vërejtur unë, se çka ka ndodhur më parë nuk e kam vërejtur, nuk më kujtohet se a kam dëgjuar bërtima. Unë e di që kanë qenë të shtrirë, a janë goditur a jo, nuk e di. Tani për tani nuk më kujtohet se ka kah shkuar U. me shoqëruesin e tij dhe J.i pas kacafytjes, por është e vërtetë ajo që kam deklaruar në shqyrtimin e datës 20.03.2019, faqe 7, ku kam deklaruar se “J.in e kam parë, ka kaluar andej është ardhur deri tek tuneli dhe është ik”. Ka ikur nga U., gjatë ndjekjes nuk më kujtohet se ka pasur diçka në dorë U.. Gjatë këtij konflikti nuk e kam parë dikë të lënduar. Në deklaratën e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 20.03.2019, pranë së cilës deklarata dëshmitari B. L. ka mbetur në tërësi, ka deklaruar se: ditën kritike kam qenë në lokal, se aty punoj, gjatë asaj kohe J.i ka ardhur

me mbush tiketë, kurse U. ka qenë para lokalit duke ndejt me një person tjetër. Të cilët ishin duke pirë birra. Të cilat ia ka shërbyer lokali afër. Ndërkohë U. e ka thirr J.in jashtë dhe nuk e di se çka ka ndodhë. Sa më duke i kanë përmendur do pare, në ato momente u rrëzua birrat që ishin jashtë, nuk i kom pa se kush i ka thyer shisheet. Aty i kanë nda dhe ka përfunduar, unë nuk kam ndërhy me i nda. Në atë moment ne e kemi mbyll lokalin. Para se me e mbyll lokalin U. më duke ka qenë në afërsi të lokalit, ka pasur edhe persona tjerë. J.in e kam pa, ka kaluar andej, është ardh deri tek lokali dhe është ik, kur kaloj nga lokali J.i, U. e të tjerët që ishin me të, e kanë ndjekur. Në atë moment unë dhe baba kemi shkuar në shtëpi. Menaxher i bastores ka qenë F. Gj., ai nuk ka qenë aty atë natë, nuk e kemi lajmëruar për rastin e ndodhur. Pas një orë që kemi shkuar në shtëpi, na ka lajmëruar menaxheri i bastores, na ka thënë se duhet me e hap bastoren se ka ardhur policia, në atë moment kemi marr vesh se janë ther. Personat që kanë qenë me U. aty nuk i kam njohur. Ka shtuar se unë në lokal rri në banak dhe vetëm shtypi tiketa. Në lokal kemi të ngjitura perde me fletëza dhe me u ngrit në këmbë pak shihet jashtë. Kur e kemi pastruar vendin, J.i ka ikur nga vendi i ngjarjes se e ka ndjekur U. dhe një person tjetër. Pasi e pastruam vendin, mbeturinat i kemi hedhur 20 metra larg në drejtim të “. . . , baba i ka hedhur. Kur kemi dal me i pastruar copëzat e shishes, i dëmtuari U. ka qenë tek shkallët në drejtim të parkingut të “. . . , J.i ka qenë diku 5-6 metra në anën e kundërt. Kjo ngjarje ka ndodhë shpejt e shpejt, ka ardhur J.i, nuk e di se çka ka thënë e këta e kanë ndjekur. Shton se në momentin kur ka dal J.i nga lokali, kam dëgjuar që janë përmendur paratë, nuk e di cila shumë, kam vërejtur se janë rreh, në momentin kur jam dal me këqyr, janë kanë të kacafytur U. e J.i, nuk i kam pa kush kujt i ka ra, pastaj i kanë ndarë disa persona, këta persona nuk i njoh. Kur kam dal jashtë i kam pa të dy të kapur, të shtrirë në tokë, U. ka qenë përsipër J.it. Nuk ka zgjatur shumë, se kanë qenë të kapur dhe në ato momente nuk e kanë goditur njëri tjetrin, se kanë qenë ashtu të kapur që ka qenë pozitive e papërshtatshme. I kanë nda baba dhe disa persona të tjerë. Të thyera kanë qenë një shishe e birrës dhe një gotë, nuk e kam parë se kush i ka thyer. Këta i kam pa në momentin kur janë nda, u largu J.i, brenda 10 minutave u ardh prape J.i dhe e kanë ndjekur, në ato momente si janë largu këta, ne e kemi mbyll lokalin dhe kemi shkuar në shtëpi.

2.2.3 Dëshmitari – **L. R.**, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: mbetëm pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor të datës 11.04.2019 dhe nuk kam se çka të shtoj, mirëpo tani për tani nuk mund të them 100% se më kujtohet se çka kam deklaruar. J. N. e njoh, pasi që jemi në mahall dhe kemi pirë kafe në mahall, po ashtu e njoh edhe U.Q.n. Me J.in nuk kam pasur ndonjëherë mosmarrëveshje. Nuk kam ndejtur ndonjëherë me J.in dhe U. bashkë. U. nuk më ka thënë që ka probleme me J.in, nuk ka ra muhabeti, vetëm atë natë kur jemi takuar që ka ndodhur rasti. Ka shtuar se kur kam shkuar në lokal aty ka qenë J.i, B., përjashta në tavolinë ka qenë i ulur U. dhe dy vetë tjerë kanë qenë brenda, nuk i kam njohur, pastaj J.i ka ardhur pas pesë minutave. J. është ulur me pa lojën dhe U. ka folur me te, u dal J.i përjashta, u ul me te, me ta ka qenë i ulur edhe një djalë i Shqipërisë, kanë bërë muhabete, ndërsa më vonë kur i kam parë janë kacafytur në mes vete, U. e kom pa që ka qu dorë së pari, J.i atëherë është ngritur duke u ngritur ka zënë në karrige dhe është rrëzuar, U. ka marrë me i rënë apët, e kom ndal U. dhe i kam thënë, lere këtë punë, janë ardhur edhe disa persona tjerë prej kafes së . . . e kanë kap J.in dhe janë ndarë, J.i ka shkuar ndërsa këta kanë ndejtur aty, pastaj J.i me B.n e kanë pastruar vendin dhe e kanë mbyll lokalin, U. me personin tjetër kanë shkuar me një lokal tjetër dhe unë kam shkuar në shtëpi. U. me atë personin tjetër kanë qenë duke pirë birrë, sa kanë qëndruar aty nuk e di. U. e ftoj J.in dhe e ka goditur i pari, unë nuk kam dëgjuar se për çka ka ndodhur rasti apo çka kanë biseduar. Është e vërtetë ajo çka kam deklaruar në deklaratën e dhënë më herët pranë kësaj gjykate, se U. i ka hip përmbi J.it dhe i ka rënë 2-3 herë J.it. Pas kësaj unë e kam largu U., ata të tjerët të cilët nuk i njoh, që kanë ardhur nga kafja e . . . e kanë larguar J.in. J.i pastaj është larguar, ka dal përpara banesës kah rruga kryesore, ndërsa ka ka shkuar nuk e di. Nuk e kam pa a e ka ndjek dikush J.in, ai i Shqipërisë ka tentuar, ku J.i iu ka thënë “hajdeni një nga një”, pastaj ka ikur. J.it i ka rënë

shuplakë në fytyrë. Në deklaratën e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 11.04.2019, pranë së cilës deklaratë dëshmitari B. L. ka mbetur në tërësi, ka deklaruar se: atë natë ka qenë një lojë e kampionatit Italian që luhej në orën 20:45/h dhe e lam me shokë me shku me e pa lojën, kemi qenë unë J. L., djali i tij B. (B.), mbasi jam ulë aty me e këqyr lojën, përjashta ka qenë i ulur U. me B. nga Shqipëria, unë jam ul me e pa lojën, ndërkohë ka ardhur J.i dhe ai është ulur brenda me e këqyr lojën, mbas nja 10 -15 minutave, U. e ka thirre J.in dhe i ka thënë a mundesh me ardh qitu, u dal J.i u ul me to , ka qendru nja 5 minuta, qetë u kon, edhe në moment e kom ndi U. kur ka piskat, me shprehje banale, pse nuk po don me mi kthyer paret dhe i ka ra J.it, atëherë J.i është ngrit në këmbë mu konfrontu me U., . u qu në kom, (U. dhe B. kanë qenë në ndikim të alkoolit), kur u qu B. në kom ka zonë në karrige dhe është rrëzuar, pastaj U. i ka hip përmbi J.it dhe i ka ra 2-3 herë, unë kam ndërhy dhe e kom kap U. dhe e kom ngrit në kom, J.i dhe një B. Sh. (i cili ka ardhur prej kafes) e ka kap J.in dhe i kanë nda, unë në atë moment e mbajsha U., u larguan pak, atëherë J.i ka filluar me i shajhtë duke iu thënë “hajdi një, nga një, nëse iu ban”, atëherë ky i Shqipërisë-B. i tha : Po mer dhe është nisur në drejtim të J.it, por unë e kom në atë moment është ardhur . . . a, vëllau i B.t dhe i tha B.t, çka ki, çka u bo dhe e ka ndalur, por B. tentojke me e sulmu J.in, në ndërkohë J.i është larguar nga vendi i ngjarjes. Në ato momente kur janë fjalosur U. dhe J.i janë thyer disa gota të cilat kanë qenë në tavolinë, pastaj U. është kthyer apet qaty, ka ndejt në këmb, duke shajtur “nuk ma ndin për kërkend, etj”, unë i kom thonë B. (B.t) dhe J.it, mbyllne se mundet me ndodh diçka, J.i me B. (B.n) e kanë mbyllur lokalin. Gjatë mbylljes së lokalit ka zgjatur diku nja 15 minuta dhe pastaj kur e kemi pa J.in kur ka ardhur në vend te lokali, e U. me B. jon kon duke ndejt te baraka e cila gjendet në drejtim të “V.”, J.i iu ka thonë edhe njëherë “hajdi ju trima, një nga një nëse doni”, atëherë U. me B. kanë shkuar në drejtim të tij me qëllim të sulmit, por J.i në atë moment ka ikur, e kom pa deri te qoshja e banesës ku shihet duhani, tek Zyra e Luftëtarëve dhe me sa kom pa unë ka shkuar në drejtim të stacionit të autobusëve, U. dhe B. kur kanë ardhur tek kafja e . . . , të cilit ishin në gjendje të dehur, U. në këtë rast e ka marrë një karrige, i cili as karrigen nuk ka mundur me e mbajt për shkak të gjendjes së dehure, dhe e ka mbajtur prej kafes së . . . , deri tek Zyrja e Luftëtarëve, meqenëse J.i iku në drejtim të stacionit, këta shkuan në atë drejtim dhe sillëshin andej pari, duke bërëtitur “hajde pse pe ik, ku je”, J.i me djalin e vet B. (B.n) kanë shkuar në shtëpi, unë jam ndal prape në kafën “. . . ”-ish kafja e . . . dhe kam dal me pi kafe me djalin e axhës. Që ka ardhur deri te përleshja e dytë nuk di as nuk kom dëgjuar asgjë. Duke qëndruar në kafe, pas 15-20 minutave po vjen J.i, se e kishin pas thirre policia, kur dola e pash policin tek lokali, në këtë moment më shkoj mendja se vetëm J.i ka mund mi thirr policin, edhe pse nuk ke ndonjë konfrontim i madh, nga policia të cilët ishin duke folur në radio lidhje, kom marr vesh se ishin ther, unë kam menduar se U. me B. e kanë ther J.in, meqenëse ata ishin dy vetë, por më vonë pasi J.i është kthyer nga policia mora vesh që J.i kishte ther U.. Ka shtuar se kam qen brenda në lokal, na ka ndaj pjesa e xhamave, nuk kam qenë larg as një metër nga U dhe J.i. Biseden mes tyre nuk e kam dëgjuar, por pastaj kur i ka thënë U. se nuk po mi lan parët e kam dëgjuar. U. i ka rënë J.it me shuplakë. J.i u ngrit në këmbë për me e kundërshtuar U., por në atë moment është qar edhe aj i Shqipërisë, atëherë J.i është tërheq është ruajtur mos po i bjen ky i Shqipërisë. J.i në teras të lokalit është kthyer vetëm pas 15 minutave, në atë moment nuk ka pas diçka në dorë. Ka shtuar se i pandehuri ka pasur veshë një maicë dhe pantallona të shkurtër, nuk kam mundur me e vërejt që ka pas diçka në xhepa. U. të akuzuarit J. i ka rënë një herë, në fytyrë. J.i kur është ngritur në këmbë, pas ramjes që e ka gjuajtur U., ka zënë në karrikë dhe është rrëzuar, në atë moment U. i ka kërcyer përsipër dhe e ka gjuajtur 2-3 herë në fytyrë, derisa jam afruar unë me e largu U.

2.3 Deklarimi i ekspertës mjeko – ligjor.

2.3.1 Ekspertja mjeko ligjore - **Dr.E. K.**, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: konstatimi në ekspertizë ku kemi konstatuar se ky lëndim sipas tabelës mjekësore orientueses për zvogëlimin e aktivitetit jetësorë është 5%, ky 5% paraqet zvogëlimin e aktivitetit jetësor për punë,

kjo duket shumë pasi që lëndimi ka qenë kritik në momentin e shkakimit sepse rrezikon jetën e pacientit kjo diagnozë, mirëpo pas sajimit të lëndimit nuk len pasoja në aktivitet të përgjithshëm jetësor më tepër se 5%, që do të thotë se nëse arrin të shërohet pacienti si në rastin konkret, çka do të thotë se aktivitet jetësor nënkupton edhe puna dhe aktivitetet tjera jetësore. Ky zvogëlim i aktivitetit jetësorë do të jetë i përhershëm për 5%. Fillimisht kemi kontaktuar pacientit dhe kemi kërkuar që të na realizoj edhe një RTG Pulmo P-A, që të shohim si e ka gjendjen e tanishme shëndetësore, i dëmtuari e ka bërë dhe e ka sjellë në QKUK, e që me rastin e dhënies së mendimit përfundimtar jemi bazuar edhe në këtë RTG, pasi që kemi dashtë që të shikojmë edhe gjendjen momentale të pacientit. Edhe nëse tani do të bëhej një ekzaminim i të dëmtuarit, nuk do të ndryshonte konstatimi të cilin e kemi dhënë në ekspertizë, as tash as pas shtatë viteve, do të jetë konstatimi i njëjtë. Për këtë përfundim, nuk ka pasur mendime të kundërta as nga mjekët A. B. dhe N. K., pasi që çdo gjë është e qartë dhe kemi qenë unik në dhënien e mendimit. Ka sqaruar se lidhur me përqindjen jemi bazuar në gjendjen e të dëmtuarit si dhe në RTG dhe tabelën mjekësore orientuese, që ka dal të jetë 5%, të cilat nuk mund t'i tejkaloj. Ka shtuar se herën e parë kur është bërë ekspertiza nga zyra ligjore kanë ardhur vetëm dy emra të eksperteve, ku kemi qenë unë dhe Dr. N. K., të cilët e kemi përpiluar ekspertizën e parë siç ju kemi dërguar, pastaj është kthyer dhe plotësuar me një ekspert tjetër. E kemi vlerësuar ekspertizën e Dr.F. B., i cili ka konstatuar se ka lëndime të lehta trupore, mirëpo unë me koleget e mi, kemi konstatuar se ka lëndime të rënda trupore, pasi që lidhur me këtë mendim jemi të specializuar në këtë fushën si ekspert torakal, hemopneumotoraxi traumatik është kërcënues për jetën e pacientit. Herën e parë kur e kemi pasur në vizitë të dëmtuarin,, në ekspertizën e datës 21.01.2019, nuk ka qenë Dr.A. B., pasi që nuk e ka caktuar zyra ligjore. U. ka qenë në ekzaminim si herën e parë edhe herën e dytë, ku herën e dytë e kemi kthyer dhe i kemi thënë që të bëhet RTG Pulmo P-A dhe më pas të kthehet me rezultatet tek ne. Në ekspertizën e dytë në ekzaminim të pacientit dhe imazherisë kemi qenë tre ekspert dhe për ekspertizë kemi punuar të tre ekspertët bashkë. Në ekspertizë është mirë me e shënu edhe vizitën e pacientit, por edhe ne në ekspertizën e parë e kemi shënuar, por në herën e dytë nuk e kemi shënuar pasi që kemi qenë të njëjtit ekspert dhe nuk ka ndryshuar përmbajtja e ekspertizës së parë dhe se nuk jemi thelluar se kur ka qenë pacienti, çka donë të thotë se ne kemi vërtetuar se çka kemi thënë herën e parë, nuk e kemi parë të nevojshme që të shënohen detajet të cilat nuk kanë ndikuar në përfundimin e mendimit. Në pyetjen e mbrojtësit të akuzuarit, av.Muharrem Hadri, se në ekspertizën e datës 21.01.2021, në rreshtin e 3-të, keni konstatuar se po shënojmë përsëri një ekspertizë të re edhe pse dokumentacioni mjekësor në këtë lëndë nuk gjendet, çka nënkupton kjo. Ekspertja ka sqaruar se aty ku është konstatuar në kllapa, është shënuar “por në ekspertizën tonë të mëparshme, po e përsërisë që janë përshkruar saktësisht lëndimet që i ka pësuar pacienti” çka do të thotë se diagnoza e cila është dhënë nga spitali “Isa Grezda” dhe nga ne, ne të cilat janë përshkruar në ekspertizën e parë diagnoza konsiderohet lëndim i rëndë trupor. Tek i dëmtuari janë konstatuar dy plagë prerëse-shpuese në regjinin nën shpatullor të djathtë, një plagë prerëse-shpuese në regjionin shpino-belor majtas dhe si pasojë e këtyre gjakderdhjeve dhe grumbullimit të ajrit të lirë në zgavrën e kraharorit të djathtë. Këto lëndime janë me mjete prerëse dhe njëra prej tyre ka enutar integritetin e pleurës së mushkërisë, të organeve të brendshme, të cilat si pasojë kanë quar në hemopneotorax. Këto lëndime nga jashtë nuk janë të dukshme sot, pasi që ka ndodhur në vitin 2017, janë si cikatiks i vogël. Për çdo kontroll të pacientit nëse pacienti ka shqetësime, kërkohet një RTG Pulmo P-A, për të konstatuar gjendjen faktike, është obligim i pacientit përderisa është një diagnozë që përshkruhet si më lartë. Unë përmes udhëzimit specialistik ku i shënoj të dhënat e pacientit, diagnozën e mëhershme, ankesat e tij dhe arsyen pse e kërkojë atë fotografim, e njëjta është e vulosur me vulë dhe faksimi të mjekut, kurse pacienti ka mundësi ta realizojë atë rëntgen në çdo shtëpi të shëndetit që posedon aparatit e rëntgenit dhe më pas ta sjelli rezultatit në bashku me fotografinë tek mjeku që e ka kërkuar, në rastin konkret tek un. Ky rëntgen nuk është konstatuar në ekspertizë sepse rezultatet i kemi parë bashkarish tre ekspertët dhe kemi parë se nuk ka kurrfarë ndryshimi nga normalja në atë RTG pulmo dhe nuk ka kurrfarë ndryshimi në kategorizimet e

peshës së lëndimit trupor në ekspertizën e dytë që na është kërkuar ta bëjmë nga ekspertiza e parë, neve na është kërkuar që ta rishikojmë dhe njëherë se a kemi të bëjmë lëndim të rëndë trupore apo jo, i cili nuk ka ndryshuar nga ekspertiza e parë gjithashtu edhe RTG e pacientit nuk ka ndryshuar nga hera e parë dhe nuk e kemi parë të arsyeshme që ta përshkruajmë. Dr.A. B. ka qenë prezentë në rastin e dytë të ekzaminimit të pacientit. Ka sqaruar se nëse eksperti Dr.F. B. nuk e ka pasur diagnozën e shënuar hemopneumotrax traumatik, i njëjti ka mundur të jap vlerësim që kemi të bëjmë me lëndim të lehtë trupor në të kundërtën po ta kishte këtë diagnozë të përshkruar do të jepte mendim tjetër.

2.4.Provat materiale

2.4.1. Nga dy raportet e hetuesit M. U., të datës 12.09.2017, me numër të rastit 2017-EA-1032, janë konstatuar veprimet hetimore të cilat janë ndërmarr nga Policia e Kosovës, ku ndër të tjera është konstatuar se me datë 11.09.2017, kemi pranuar rastin që kishte ndodhur në rrugën “Nënë Tereza”, në Gjakovë, ku viktimja e këtij rasti ishte U.Q., i cili nga lëndimet e marra ishte dërguar në QKUK-Prishtinë, kemi vazhduar me hetimin e këtij rasti edhe me datë 12.09.2017 së bashku me Rreshter D. B. kemi shkuar në QKUK-Prishtinë, ku ka qenë duke u trajtuar viktimja U.Q., i cili në deklaratën e tij ka thënë se ka qenë duke pirë birra me një person, me nofkën “B.”, për një moment e ka parë personin J., se i njëjti i ka gjashtëdhjetë (60) Euro borxh dhe pasi që i njëjti i është përgjigjur se ato para mos me i përmend asnjëherë, ka deklaruar se kishte tentuar ta godiste dhe se kishin pasur një përleshje fizike, por ishin ndarë, pastaj kishin ardhur J.i, vëllai i tij, kishin pasur thika me vete dhe kishin qen edhe dy apo tre persona te tjerë që nuk i njoh, e kishin goditur, ku viktimja deklaroi se e kishte goditur me thike ne shpin dhe se e gjithë ngjarja ka ndodhur për një borxh.

2.4.2. Nga leximi i Raportit fillestar të incidentit të Policisë së Kosovës, me numër 2017-EA-1032 të datës 10.09.2017, Raporti i hetuesit H. M. i datës 10.09.2017 dhe Flesh Raporti i Policisë së Kosovës, me numër të rastit 2017-EA-1032 të datës 10.09.2017, Raporti i oficerit K. Th. dhe K. Sh., me numër të rastit 2017-EA-1032 të datës 11.09.2017, Raporti i oficerit A. B., i datës 10.09.2017 dhe Raporti i Oficerit A. R., i datës 10.09.2017, gjykata ka konstatuar se me datë 10.09.2017, rreth orës 22:00, në Policinë e Kosovës është raportuar se ka ndodhur një rrahje prapa “. . . Store”, me ç’ rast një person ishte dërguar në emergjencë për tretman pasi që kishte lëndime të rënda, në këto raport janë përshkruar veprimet hetimore të ndërmarr nga Policia e Kosovës, ashtu që hetuesit policor pasi që kanë shkuar në vendin e ngjarjes, janë shkuar në emergjencën e spitalit rajonal të Gjakovë, ku janë informuar se personi U.Q. kishte lëndime të rënda trupore dhe duhet të dërgohet në QKUK-Prishtinë, i cili ka qenë në dhomën e reanimacionit duke e marr tretmanin mjekësor, me lejen e stafit mjekësor policët kanë tentuar të kontaktojnë viktimën U.Q., ku pastaj pasi i është kërkuar data e lindjes, ka refuzuar ta jap dhe është bërë agresiv ndaj policisë, dyshohej se ishte ne gjendje të dehur, pas një kohë është qetësuar prapë, ku ka pranuar të merr ndihmë mjekësore, pas tretmanit me autoambulancë është dërguar në QKUK-Prishtinë.

2.4.3. Nga raporti i Spitalit Rajonal “Isa Grezda” – Reparti i Emergjencës, numër 12703, i datës 10.09.2017, është konstatuar, se i dëmtuari U.Q., është pranuar në këtë repart me lëndime të marra në përleshje fizike (therje me thikë), pas trajtimit është transferuar në Qendrën Emergjente në QKUK.

2.4.4. Nga Fletë lëshimi i Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Klinika e Kirurgjisë Torakale, me numër 6886, dhe dy dëftesë pagesa, është konstatuar se i dëmtuari U.Q., me datë 11.09.2017 është pranuar në klinikë për shkak të lëndimeve të marra pas konfliktit, me mjet të mbrehtë, lëndimet ishin në formë të plagëve shqyese në regjionin infrascapulare djathtas

(II) dhe në regjionin torakolumbal majtas (I). I njëjti është lëshuar për mjekim në shtëpi me datë 14.09.2017.

2.4.5. Nga akt ekspertimi mjeko ligjor i Dr.F. D., i datës 05.10.2017, është konstatuar se në bazë të raporteve mjekësore në shkresat e lëndës, dëmtimet e përshkruara në gjetje – konstatime paraqesin: plagë prerëse-shpuese në anën e majte të shpinës dhe në regjionin e shpatullës së djathtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të mprehtë dhe me maje, që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, këto dëmtime kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit. Ka bërë vërejtje se në raport thuhet se transferohet në QKUK, mirëpo mungon raporti mjekësor, nëse sigurohet raporti mund të bëhet rivlerësimi dhe rikualifikimi i dëmtimeve trupore.

2.4.6. Nga akt ekspertimi mjeko ligjorë – plotësim mendimi i Dr.F. D., i datës 16.03.2018, është konstatuar se pas sigurimit të fletë lëshimit nga Kirurgjia Torakale – QKUK Prishtinë, në emër të U.Q., mjekuar nga data 11.09.2017 deri me datë 14.09.2017, shihet me se vijon: plage shpuese në regjionin nën shpatullën e djathtë (2 në numër) dhe në kufirin e pjesës së poshtme të anës së majtë të kraharorit me pjesën ijore (1 në numër). Grumbullim gjaku në zgavrën e djathtë të kraharorit pas traumës së pësuar. Torakostomi e kraharorit dhe nxjerrjen e rreth 200 ml gjak. Këto dëmtime kanë qenë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të mprehtë, me mekanizëm shpues, që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore. Këto dëmtime kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

2.4.7. Nga akt ekspertimi mjeko ligjore, i përpiluar nga kirurget torakal, Dr.E. K. dhe Dr.N. K., e datës 21.01.2019, është konstatuar se i dëmtuari U.Q., me datë 10.09.2017 nga mjete i mbrehte ka pësuar këto lëndime; plagë prerëse-shpuese (II) në regjionin nën shpatullor të djathtë, 2) një plagë prerëse-shpuese në regjionin shpino-belor majtas dhe gjakderdhje dhe grumbullim i ajrit të lirë në zgavrën e kraharorit të djathtë. Të cilat lëndime kategorizohen si lëndime të rënda trupore për shkak të zhvillimit të hemopneumothoraxit (gjakderdhjes dhe ajrit të lirë në zgavrën e kraharorit).

2.4.8. Nga akt ekspertimi mjeko ligjore - plotësimi, i përpiluar nga kirurget torakal, Dr.E. K., Dr.A. B. dhe Dr.N. K., e datës 11.01.2021, është konstatuar se i dëmtuari U.Q., ka pësuar lëndime nga mjete i mprehtë me datë 10.09.2017, ka pësuar lëndimet si vijon; plagë prerëse-shpuese (II) në regjionin nën shpatullor, një plagë prerëse-shpuese në regjionin shpino-belor majtas dhe gjakderdhje dhe grumbullim të ajrit të lirë në zgavrën pleurale të kraharorit djathtas. Lëndimet e lartshënuara kategorizohen si lëndime të rënda trupore, për shkak të zhvillimit të Hemopneumothoraxit Traumatik (gjakderdhjes dhe ajrit të lirë në zgavrën e kraharorit). Ky lëndim sipas tabelës mjekësore orientuese për vlerësimin e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor është 5%.

2.5 Mbrojtja e të akuzuarit

2.5.1 I akuzuari - **J. N.**, gjatë shqyrtimit kryesor nuk e ka pranuar fajësinë ndërsa në mbrojtën e tij ka deklaruar se: data nuk po më kujtohet por e di se kam shkuar në bastoren “. . .”, në momentin kur kam shkuar ka qenë një tavoline jashtë me dy karrige, aty ka qenë i ulur U. me një shok të vetin, i kam përshëndetur dhe kam hyrë brenda, arsye e shkuarjes në bastore ka qenë me e shtyp një bastore dhe në momentin që isha duke e shtypur bastoren më ka thirrur U. në mënyrë urdhëruese “paja këtu”, ku unë iu kam përgjigjur vetëm një minutë, e kom shtyp tiketën dhe kam dal jashtë, kam qëndruar në këmbë ndërsa duart i kam pasur mbi tavolinë, ku U. më ka thënë “a po mi jep qato pare”, në mënyrë urdhërore, i kam thënë “nuk kam”, edhe pse e vërejtja se ishte në ndikim të alkoolit, i kam thënë se nuk i kam për momentin, por edhe ti kisha ia kisha dhënë për t’

iu shmangur konfliktit dhe i kam thënë se në momentin kur ti bojë, të thirri dhe ti jap, ndërsa U. ka filluar me shajt në mënyrë më banale, duke cekur nënën, motrat dhe duke më thënë se do të vras. Unë u frikova prej U. dhe prej personit që ishte me te dhe mënyra se si më tha se do të vras, pasi që personi që ishte me te, e kanë thirrur B. në atë kohë, ka qenë i madh fizikisht dhe jam frikësuar, U. është quar në këmbë dhe se nuk më kujtohet se a më ka goditur me shuplakë apo me pjesën e epërme të poshtme të dorës, në atë moment personi që ishte me te më ka shtyrë dhe unë kam rënë prapa me bërryla, në atë moment U. më ka hip përmbi dhe sot që më kujtohet e di që kanë qenë mbi 5-6 goditje, ku më kanë goditur që të dy, personi i Shqipërisë më ka goditur me shkelma në pjesën e fytyrës, ndërsa U. më ka goditur me grushte. Nuk e di as vet se si jam shmangur dhe kam tentuar që të iki, kur kam ikur prapë më kanë shajtur me fjalë të ndryshme, ndërsa e vetmja fjalë që më kujtohet që kanë thënë se do të vras, në atë moment jam frikësuar shumë dhe më kanë ndjekur pas, nuk e di distancën diku 100 metra, pasi jam kthyer prapa i kam parë se nuk është pasi që isha me shorce në atë moment dhe me papuqe plazhi dhe e kam parë që nuk e kam telefonin në xhep, kam hyrë te një hyrje te banesat dhe kam dal prapa parkingut të “. . .”, kur jam afruar tek dyqani që mbarojnë çelësa më ka dal U. përballë, personi i Shqipërisë ka qenë në dyqan që shesin produkte ushqimore dhe e kam parë që më kanë rrethuar dhe në moment e kam parë se U. mbante një thikë me dorezë të kuqe, e cila thikë ka qenë opcionale me gërshërë, etj, ndërsa ai personi e ka pasur një thikë të kasapave të cilën mendojë se e ka marrë në shitoren ushqimore dhe mu kanë ofruar që të dytë dhe nuk kam pasur nga të shkojë dhe e kam parë se U. është nën ndikim të alkoolit, ka tentuar me më rënë, ia kam kapur dorën, ia kam tërhequr thikën prej dorës, në ato momente më ka kap paniku pasi isha i rrezikuar shumë edhe nga personi tjetër që e kisha në distancë 1.50 m, dhe në ato momente nuk e di se sa i kom ra, ku i kom ra. As vet nuk e di se pastaj çka kam bërë, duke e pyetur vetën se si shpëtova, se si ndodhi kjo, jam larguar prapë duke ikur, duke menduar se po më vine prapa edhe pse ai personi në fjalë më ka ndjekur, por një kohë të shkurtë. Në shitoren që e potencova që e ka marrë thikën, ata shesin peme dhe perime, por e kanë edhe një tavolinë ku rrinë persona. Ka shtuar se unë pasi që kam pasur gjendjen e dobët ekonomike dhe kam pasur prindërit e sëmurë, kam punuar në Bastoren “. . .” tek H. ushqimorja, përball B, ku kam punuar gjashtë muaj dhe aty e kam njohur U, pasi që ka qenë myshteri, çka do të thotë se U. e kam njohur dy muaj para se të ndodhë rasti. Nuk kam pasur ndonjëherë konflikt me askënd, pasi që kam punuar dymbëdhjetë (12) vite kamarier, e nuk kam pasur ndonjëherë konflikt. Shuma që mi ka kërkuar i dëmtuari U., ka qenë pesëdhjetë (50) Euro, që nuk i kam pasur atë kohë. Nuk ia kam pasur borxh por mi ka fal, pasi që para disa ditëve unë i kam treguar një lojë të cilën e ka luajtur dhe i ka fituar disa të holla dhe mi ka falur ato pesëdhjetë (50) Euro, afërsisht një (1) muaj para rastit kritik. Nuk kam hyrë borxh ndonjëherë tjetër nga U. Në hyrje të lokalit-bastores u ktheva prapë pasi isha sulmuar nga këtu i dëmtuari, pasi që siç tregova edhe më herët kam qenë me shorce dhe më kishte rënë telefoni, tek dyert e dyqanit të çelësave, pasi që aty jam rrëzuar dhe sot e asaj dite nuk e kam gjetur telefonin. E kuptova që më kishte rënë telefoni pas 3-4 minuta. Ka qenë ndriçim i mjaftueshëm për me u vërejte jashtë, por ka qenë ndriçimi nga brendia e bastores. Është e saktë ajo që kam deklaruar se isha i kanosur nga personi që kishte thikë në dore dhe nga personi i cili ishte me të dëmtuarin U dhe vrapoj pas meje për të më nxënë. Nuk e lajmërova policinë për rastin, pasi që nuk kam pasur mundësi. Nuk më kujtohet se çka kam vepruar pasi që e kam goditur U, pasi që kam qenë i shqetësuar. I dëmtuari U. ka qenë i ulur vetëm me personin që i thonë B., të cilët kanë qenë duke pira dhe ajo u vërejte nga kundërmimi. Shtëpinë e kam larg bastores 15 minuta, pasi që e kam shtëpinë tek shkolla e mesme e mjekësisë “Hysni Zajmi”. Ka shtuar se unë nuk e kam pritur që U. mi kërkon ato të holla, pasi që mi ka falur, për afërsisht një muaj para rastit. Në atë kohë kam qenë duke punuar si sigurim i drejtorit të Kolegjit “Mehmet Akif”. Unë ja kam marrë thikën prej dorës U. Nga policia jam arrestuar pas katër ditësh, pasi që kam qenë në shtëpi dhe nuk më ka kontaktuar askush nga policia. I kam dërguar njerëzit tek U. për tu pajtuar, por nuk jemi pajtuar pasi na ka kërkuar të holla, njëzet mijë (20,000.00) Euro, por nuk jemi pajtuar pasi që unë kisha rrogë dyqind (200) Euro. U. e njoh

si myshteri, nuk kam ndejtuar as pirë kafe ndonjëherë me të. Nuk vjen në shprehje t'i kem kërkuar borxh shumë prej tridhjetë (30) Euro. Ditën kritike mi ka kërkuar pesëdhjetë (50) Euro. Unë jam kthyer për ta marr telefonin siç thashë, i kanë pasur thikat kur kam shkuar me e marr telefonin, e jo kur më kanë goditur. Thikën ia mora në atë moment, pasi që shpirti i ëmbël shumë, por unë kam rripin e zi në karate dhe kam arritur të ia marr thikën nga dora. Në momentin që ia kam marr U. thikën, unë e kam qit U. përpara nuk e di se si e kam goditur, jam munduar me e mbrojte vetën pasi që personi që e kisha pas ishte me emër B.. Në momentin që e mora thikën nga U., personi tjetër dojke mem ra, mirëpo në lëvizje e sipër unë iu kam shmangur. Nuk e di me emër kënd e kemi dërguar tek U. për me u pajtur, por e di që kanë qenë nga Raushiqi i Pejës apo Vitomerica, pasi që ata i ka dërguar babi im, e ai ka vdekur që dy muaj, ndërsa ia kam dërguar edhe Sh. e . . . , por ka thënë se nuk bisedoj me të. Ka shtuar se U. mi ka falur pesëdhjetë (50) Euro, në bastoren “. . .”. Nuk e di se cilin person e kemi dërguar për me u pajtu, që ia kanë kërkuar njëzetë mijë (20,000.00) Euro, prindi im i ka dërguar, por e di që merren me faljen e gjaqeve. Intervali kohor prej përleshjes te dera e bastores e deri tek përleshja me thikë ka qenë përafërsisht dhjetë minuta. Unë nuk kam pasur lëndime nga thika. Gjatë periudhës prej kur mi ka falur pesëdhjetë (50) Euro, e deri kur ka ndodhë rasti, rreth një muaj, jemi takuar në bastoren “. . .”, por të hollat gjatë kësaj kohe nuk mi ka kërkuar. Në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues, se ju në deklaratën e dhënë në prokurori, faqe 2, ku jeni pyetur “se ti si vepro”, jeni përgjigjur se “ unë e vërejta se më kish ra telefoni nga xhepi, jam kthyer me e marrë, në momentin që jam kthyer me e marrë e kam pa se edhe U. kishte thikë në dorë, më kanë mësy tek një trafik tek “. . .”, U. më ka kap më ka shtri prap, mandej kam arritur me ja marrë thikën prej dorës atij të Shqipërisë, ndërsa në deklaratën e sotme po thoni se U. ia kam marrë thikën. Cila është e vërteta a ja keni marrë thikën U. apo ati të Shqipërisë prej dorës. I akuzuari është përgjigjur se unë besoj që ia kam marr U., pasi që nuk e di, pasi që kam qenë i humbur. Ka shtuar se i kam tre vëllezër, njëri invalid i luftës, ndërsa jetoj me nënën dhe dy motra të martuara.

3. Elementet e veprës penale

Në nenin 186 par.1 nën par.1.3 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale lëndim i rëndë trupor e kryen: “*Kushdo që i shkakton tjetrit lëndim të rëndë trupor ose e dëmton shëndetin e personit tjetër deri në masën e tillë sa që mund të rezultojë me;*” nën par.1.3. “*dëmtim të përkohshëm dhe serioz të shëndetit të personit tjetër.* Ndërsa në par.3 nën par.3.1. të këtij nenin parashihet se “*Kur vepra penale nga par.1 ose 2 i këtij neni është kryer me armë, mjet të rrezikshëm apo ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit kryerësi dënohet me:*” nën par.1.3. “*burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet për veprën penale nga par.1 i këtij nenit.*”

4. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se nuk duhet t'i falet besimi deklaratimit të akuzuarit J. N., të dhënë gjatë seancave të shqyrtimeve gjyqësore me të cilën nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale lëndim i rëndë trupor, ndërsa i akuzuari nuk e mohon faktin se e ka goditur të dëmtuarin me thikë, por ka deklaruar se “*në momentin që isha duke shtypur bastore më ka thirr U. në mënyrë urdhëruese “paja këtu”, e kam shtyp tikitën dhe kam dal jashtë, kam qëndruar në këmbë, ndërsa duart i kam pasur mbi tavolinë, ku U. më ka thënë a po mi jep qato pare, pasi e vërejta që ishte nën ndikimin e alkoolit, i kam thënë nuk i kam për momentin, ndërsa U. ka filluar mem shajhtë në mënyrë banale dhe duke më thënë se do të më vras, U. është ngritur në këmbë dhe nuk më kujtohet a më ka goditur me shuplakë apo me pjesën e epërm të poshtme të dorës, në atë moment personi që ishte me të “B.”, më ka shtyrë dhe unë kam rënë prapa*”

me bërryla, në atë moment U. më ka hip përmbi dhe sot cfarë më kujtohet e di që kanë qenë 5-6 goditje, ku më kanë goditur që të dy, personi i Shqipërisë më ka goditur me shkelma në pjesën e fytyrës, ndërsa U. më ka goditur me Grushte. Nuk e di se si kam ikur, kur kam ikur prapë më kanë shajtë dhe me kanë thënë se do të më vras, më kanë ndjekur pas, nuk e di distancën diku 100 metra. U ktheva prapë në hyrje të lokalit-bastores, pasi isha sulmuar nga i dëmtuari, pasi kam qenë në shorce dhe me kishte rënë telefoni tek dyert e dyqanit të çelësave, pasi aty jam rrezuar, e kuptova që më kishte rënë telefoni pas 3-4 minuta, kur jam kthyer kam hyr te një hyrje te banesat dhe kam dal prapa parkingut të “. . .”, kur jam afruar tek dyqani që mbarojnë çelësat më ka dal U. përball, personi i Shqipërisë ka qenë në dyqan që shesin produkte ushqimore dhe e kam parë që më kanë rrethuar, në momentin që e kam parë U. që mbante një thikë me dorezë të kuqe, e cila thikë ka qenë opcionale me gërshërë, ndërsa ai personi ka pas një thikë të kasapave të cilën mendojë se ka marr në shitoren ushqimore dhe mu kanë ofruar që të dy dhe nuk kam pasur nga të shkoj, e kam parë që U. është në ndikim të alkoolit, ka tentuar mem më rënë, ia kam kapur dorën, ia kam tërhequr thikën prej dore, në atë moment më ka kap paniku, pasi isha i rrezikuar shumë edhe nga personi tjetër që e kisha në distancë 1.5 metra dhe në ato momente nuk e di se sa i kam ra. Gjykata nuk ja fali besimin deklaramit të akuzuarit për shkak se deklarimi i tillë sipas vlerësimit të gjykatës është bërë thjeshtë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe për faktin se deklarata e të akuzuarit është kundërthënëse me vet deklaratën e tij të dhënë në prokurori, ku ka deklaruar se “U më ka kap më ka shtri prapë, mandej kam arritur me ia marr thikën prej dorës atij të Shqipërisë”, ndërsa gjatë mbrojtjes së tij ka deklaruar se “e kam parë se U. është nën ndikimin e alkoolit, ka tentuar me më rënë, ia kam kapur dorën, ia kam tërhequr thikën prej dorës, unë ia kam marr thikën prej dorës U.”, e po ashtu deklarimi i të akuzuarit është në kundërshtim edhe me provat të cilave gjykata ju ka falur besimin, siç është deklarata e dëshmitarit J. L., i cili ka dëshmuar se “kur kam dëgjuar zhurmën e gotës që është thyer, kam dal jashtë dhe i kam parë të kacafytur dhe i kam thënë atij shoqëruesit kape ti tëndin dhe kanë ndëryhrë disa veta dhe i kanë nda. Janë grushtuar mes vete, i cili ka zgjatë 1-2 minuta dhe i kemi ndarë. Pas ndarjes, U. e kam pa tek shkallët të cilat janë në krahun nga parkingu i “. . .”, kurse J.in e kam pa në afërsi të bastores. Pasi u larguan nga aty, unë e fshina vendin dhe e mbylla lokalin, gjatë kohës sa isha duke e pastruar lokalin, u kthye J.i, kur isha duke e pastruar lokalin dhe në atë moment ka thënë “hajdi qetash një nga një”, jashtë lokalit nuk ka ndriqim, por në atë moment e kam dëgjuar shokun e U., që ka thënë a edhe thikë paske, por me e pa nuk e kam pa se a ka pas thikë në dorë. Atëherë e kam mbyll lokalin dhe kam vazhduar me djalin në shtëpi, duke ecur më larg, nga lokali i L., më nuk kemi par asgjë, vetëm kur na kanë thirr policia”, po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit B. L., gjykata ka vërtetuar se “i akuzuari dhe i dëmtuari U., me datë 22.02.2019, janë përlëshur para lokalit – bastores “. . .”, i cili ka dëshmuar se “unë i kam parë duke u përlëshur jashtë dyqanit, unë kam qenë brenda në dyqan, i akuzuari J. ka qenë në tokë, ndërsa U. ka qenë mbi të, pastaj i kemi ndarë dhe janë larguar, pastaj i kam pastruar shishet e thyera dhe e kam mbyll lokalin dhe kam shkuar në shtëpi. Kur kemi dal me i pastruar copëzat e shishes, i dëmtuari U. ka qenë tek shkallët në drejtim të parkingut të “. . .”, J.i ka qenë diku 5-6 metra në anën e kundërt, ka ardh J.i nuk e di se çka ka thënë, e këta e kanë ndjek, në ato momente si janë larguar këta e kemi mbyll lokalin dhe kemi shkuar në shtëpi”, Gjykata ia fali besimin dëshmisë së tij pasi që i njëjti ka qenë punëtor në bastoren të cilën ka ndodhur rasti dhe ka qenë në ngjarje me të gjithë rastin që nga ardhja e të dëmtuarit dhe akuzuarit në lokal, e deri në mbylljen e lokalit nga i njëjti, si dhe dëshmia e tij është në harmoni me dëshminë e dëshmitari J. L.. Nga dëshmitari L. R. i cili ka dëshmuar se “ U. ka folur me J.in, është dal J.i përjashta, me ta ka qenë i ulur edhe një djalë i Shqipërisë, ndërsa më vonë i kam parë janë kacafytur në mes vete, U. e kam pa që ka qu dorë se pari, J.i atëherë është ngritur, ka zënë në karrige dhe është rrëzuar, U. ka marr me i ra apet, e kom ndal U., janë ardh edhe disa persona tjerë prej kafes së . . . e kanë kap J.in dhe janë ndarë. J.i ka shkuar, këta kanë ndejt aty, pastaj J.i me B.n e kanë pastruar vendin dhe e kanë mbyll lokalin. J.i pastaj është larguar. Gjatë mbylljes së lokalit që ka zgajt diku 15 minuta, kur e kemi pa J.in ka ardhur në vend te lokali, U. me B. janë

kanë duke ndejt të baraka e cila gjendet në drejtim të “. . .”, J.i iu ka thënë edhe njëherë hajdeni ju trima një nga një nëse doni, atëherë U. me B. kanë shkuar në drejtim të tij, por J. në atë moment ka ikur, e kam parë deri tek qoshja e banesës ku shihet duhani, Zyra e Luftëtarëve, me sa kam parë unë ka shkur në drejtim të stacionit të autobusëve. Që ka ardhur deri tek përleshja e dytë nuk e di, as nuk kam dëgjuar asgjë. Ka shtuar se bisedën mes tyre nuk e kam dëgjuar, por pastaj kur i ka thënë U. se nuk po mi lan paret e kam dëgjuar”. Prandaj gjykata ia ka falur besimin edhe këtij dëshmitari, pasi që dëshmia e tij ka lidhshmëri me deklaratimet e dy dëshmitarëve tjerë J. dhe B. L. dhe provat materiale. Nga ekspertiza mjeko ligjore-plotësim mendimin, e përpiluar nga **Dr.F. D.**, e datës 16.03.2018, ekspertiza mjeko ligjore, e përpiluar nga kirurget torakal **Dr.E. K.** dhe **Dr.N. K.**, e datës 21.01.2019 si dhe nga ekspertiza mjeko ligjore, e përpiluar nga kirurget torakal, **Dr.E. K.**, **Dr.A. B.** dhe **Dr.N. K.**, e datës 11.01.2021, në të cilat ekspertiza është konstatuar se i dëmtuari U.Q., ka pësuar lëndime nga mjeti i mprehtë me datë 10.09.2017, ka pësuar lëndime si vijon: plagë prerëse-shpuese (II) në regjionin nën shpatullor, një plagë prerëse-shpuese në regjionin shpino-belor majtas dhe gjakderdhje dhe grumbullim të ajrit të lirë në zgavrën pleurale të kraharorit djathtas. **Lëndimet e lartshënuara kategorizohen si lëndime të rënda trupore**, për shkak të zhvillimit të Hemopneumothoraxit Traumatik (gjakderdhjes dhe ajrit të lirë në zgavrën e kraharorit), ky lëndim sipas tabelës mjekësore orientuese për vlerësimin e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor është 5%. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, ekspertja mjeko ligjore **Dr.E. K.** ka sqaruar se 5%, paraqet zvogëlimin e aktivitetit jetësor për punë, i cili do të jetë i përhershëm. Çka do të thotë se mund të konstatohet se në veprimet e të akuzuarit J. N., formohen elementet e veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.3 të KPRK-së, për çka kjo Gjykate të njëjtin e ka shpallur fajtor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit, se nga kjo që është vërtetuar në këtë çështje, është rast i pa kontestueshëm se i akuzuari kishte vepruar në mbrojtje të nevojshme, gjykata e mori si të pabazuar pasi që vlerësoi se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me mbrojtje të nevojshme, pasi që për të ekzistuar mbrojtja e nevojshme një ndër elementet kryesore është që sulmi të jetë i atëçastshëm – aktual, sulmi është i atëçastshëm në çdo rast kur pritet të filloj, kur ka filluar të veproj dhe gjersa të zgjas, përkatësisht derisa të përfundoj. Në këtë kuptim, kur pushon së vepruari sulmi, apo kur sulmi refuzohet apo zotërohet, duhet të pushoj, të ndalet edhe mbrojtja, nëse sulmuesi ka pushuar së vepruari ose sulmi është zmbraur, çdo veprim i mëtejshëm i personi që ka qenë i sulmuar, nuk do të konsiderohet mbrojtje e nevojshme. Prandaj sipas deklaratimeve të dëshmitareve të elaboruara më lartë, të cilëve gjykata ua ka falur besimit, është vërtetuar se pas përleshjes ndërmjet të akuzuarit J. N. dhe të dëmtuarit U.Q., e cila ka ndodhur para bastores “. . .” dhe ka zgjatur 2-3 minuta, të njëjtit janë ndarë nga personat që kanë qenë të pranishëm aty, pastaj J.i është kthyer përsëri pas disa minutave duke u thënë “hajdeni qetash një nga një”, dhe ka ikur prape. Dëshmitarët J. L. dhe B. L. kanë deklaruar se i kanë pastruar shishet e thyera para lokalit gjatë përleshjes, i kanë mbledhur mbeturinat, i kanë hedhur dhe pastaj e kanë mbyllur lokalit dhe kanë shkuar në shtëpi, e që sipas deklaratimit të dëshmitarit L. R., mbyllja e lokalit ka zgjatur rreth 15 minuta. Që do të thotë se nga përleshja e të dëmtuarit U. me të akuzuarin J., e deri tek veprimet e ndërmarra nga i akuzuari me të cilat të dëmtuarit U. i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore, ka qenë një interval kohore më i gjatë se 15 minuta, andaj për këto arsye gjykata pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit e mori si të pa bazuar, pasi që veprimet e ndërmarra, pasi që të pushoj sulmi, apo pas zmbraurjes së tij, nuk mund të konsiderohen mbrojtje e nevojshme. Po ashtu thirrja për konflikt fizik, përjashton mundësinë që veprimet e pjesëmarrjes në konfliktin fizik të konsiderohen si mbrojtje e nevojshme, e që nga deklaratat e dëshmitareve të elaboruar më lartë, është konstatuar se i akuzuari J., disa minuta pas përleshjes para bastores “. . .”, ku ishin ndarë nga të pranishmit, i njëjti është kthyer duke iu drejtuar të dëmtuarit me fjalët “hajdeni qetash një nga një”, prandaj, për arsyet e cekura më lartë gjykata pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit, se i akuzuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshme e mori si të pa bazuar.

Pretendimet e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av. Muharrem Hadri, se i akuzuari pas 3-4 minutave nga përlëshja, e vëren që i ka rënë telefoni dhe kthehet për ta marr tek shitorja që mbaron çelësa, aty U. dhe shoqëruesi i tij e kishin bllokuar që mos të mund të ik dhe U. kishte në dorë një thikë me ngjyrë të kuqe, po ashtu thikë në dorë kishte edhe i quajtur B. dhe se kur U. ka tentuar ta godas, i akuzuari ia ka marr thikën U. dhe duke u mbrojtur e ka goditur me vet thikën e U., gjykata këto pretendime i mori si të pa bazuara, pasi që të njëjtat nuk janë vërtetuar më asnjë nga provat materiale dhe deklaramet e dëshmitarëve të cilëve gjykata ua ka falur besimin, të cilët njëjtte kanë deklaruar se pas përlëshjes tek bastore “. . .”, e cila ka zgjat 2-3 minuta, i kemi ndarë, U ka qëndruar tek shkallet të cilat janë në krahun e majtë, ndërsa J.i është larguar në drejtimin e kundërt, pastaj dëshmitaret J. dhe B. L. kanë deklaruar se pas përlëshjes kemi dal dhe e kemi pastruar para bastores, ku kanë qenë të thyera një shishe e birrës dhe një gote, (asnjëri nga dëshmitaret nuk ka deklaruar se aty ka pasur ndonjë telefon), të cilat mbeturina i kemi mbledhur dhe i kemi hedhur pas ndërtesës ku gjendet shoqata e pensionisteve, pasi i kemi hedhur mbeturinat, kemi qenë duke e mbyll lokalit, në atë moment u kthye J.i dhe ka thënë “hajdi qetash një nga një” dhe ka ikur përsëri, e që sipas deklaramet të dëshmitarit L. R., J.in e kam parë deri tek qoshja e banesës ku shitet duhani, tek Zyra e Luftëtarëve dhe me sa kam parë unë ka shkuar në drejtim te stacionit, sipas të njëjtit dëshmitar, nga përlëshja e parë e deri tek mbyllja e lokalit, intervali kohor ka qenë rreth 15 minuta, andaj nga elaburimi i këtyre deklarametave del se pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të akuzuarit dhe i të akuzuarit janë të pavërteta, pasi që të njëjtat janë në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitareve të cilëve gjykata ua ka falur besimin, e që u elaburuan përsëri në këtë paragraf, e po ashtu edhe vet deklaramet i të akuzuarit është kundërthënëse me deklarametën e tij të dhënë në prokurori, ku ka deklaruar se *“U. më ka kap më ka shtri prapë, mandej kam arritur me ia marr thikën prej dorës atij të Shqipërisë”*, ndërsa gjatë mbrojtjes së tij ka deklaruar se *“e kam parë se U. është nën ndikimin e alkoolit, ka tentuar me më rënë, ia kam kapur dorën, ia kam tërhequr thikën prej dorës, unë ia kam marr thikën prej dorës U.”*, prandaj gjykata këto pretendime i mori si të pa bazuara, pasi që sipas vlerësimit të gjykatës, këto pretendime janë thjeshtë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale.

Andaj, gjykata nga provat të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, pas vlerësimit dhe analizimit të tyre një nga një, e pastaj në lidhje me njëra tjetrën, ka ardhur në përfundim se nuk mund t’i falet besimi mbrojtjes së të akuzuarit dhe mbrojtësit av. Muharrem Hadri, ku është theksuar se i akuzuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, për faktin se nga deklaramet e dëshmitarëve të cekur më lartë dhe ekspertit mjeko ligjore dhe nga mënyrë e veprimeve të akuzuarit është vërtetuar se i akuzuari me dashje ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.3 të KPRK-së, pasi që të dëmtuarin e ka goditur me thikë dy herë në regjionin nën shpatullor të djathtë dhe një herë në regjionin shpinor-belor majtas, të cilat lëndime sipas ekspertizës mjeko ligjore të përpiluar me datë 11.01.2021, nga kirurget torakal Dr.E. K., Dr.A. B. dhe Dr.N. K., kategorizohen si lëndime të rënda trupore, sipas së cilës ekspertizë por edhe sipas deklaramet të ekspertes mjeko-ligjore Dr.E. K.t, të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, ky lëndim të dëmtuarit sipas tabelës orientuese i paraqet 5% zvogëlim të aktivitetit jetësor për punë, i cili është i përhershëm, andaj sipas vlerësimit të gjykatës pretendimet e të akuzuarit - mbrojtësit të tij janë bërë thjeshtë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe se mbrojtja e tij është në kundërshtim me të gjitha provat të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor e të cilave gjykata iu ka falur besimin e që janë elaburuar më lartë, por edhe mbrojtja e të akuzuarit pjesërisht është në kundërshtim edhe me vet deklarametën e tij të dhënë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, andaj Gjukata mbrojtjes së të akuzuarit nuk ia fali besimin, pasi që është në kundërshtim me deklaramet e të dëmtuarit, dëshmitarëve, ekspertit dhe provave materiale dhe ka vërtetuar se me veprimet e të akuzuarit J. N. janë vërtetuar dhe janë formuar elemente e veprës

penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, andaj duke u bazuar në të lartcekur Gjykata të akuzuarin e ka shpallur fajtor.

5. Vendosja lidhur me propozimet e palëve gjatë procedurës

Prokurori i shtetit Ali Uka, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka propozuar që dëshmia e dëshmitarit B. B., e dhënë në St.Policor në Gjakovë, me datë 13.09.2017, të lexohet si provë, pasi që i njëjti është shtetas i Republikës së Shqipërië dhe përkundër disa tentimeve të bëra nga ana e gjykatës nuk është arritur të sigurohet prania e tij në këtë shqyrtim gjyqësorë. Këtë propozim e ka refuzuar trupi gjykues, pasi që ka vlerësuar se këtu kemi të bëjmë me marrje në pyetje në procedurë paraprake, që sipas dispozitës ligjore të nenin 123 par.2 të KPP-së, “*provat e siguruar gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake nuk mund të përdoren si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor*”, si dhe për faktin se mbrojtësi i të akuzuarit, av.Muharrem Hadri dhe i akuzuari J. N., e kanë kundërshtuar leximin e kësaj prove.

Gjykata ka refuzuar edhe propozimin e mbrojtësit të akuzuarit J. N., av.Muharrem Hadri, që në këtë çështje të caktohet prapë ekspertizë mjeko ligjore lidhur me lëndimet e të dëmtuarit U.Q. si të pabazuar, për faktin se gjykata lidhur me lëndimet e të dëmtuarit ka nxjerrë ekspertizën plotësuese të përpiluar nga eksperti Dr.F. B. të datës 16.03.2018 i cili ka konstatuar lëndimet, po ashtu edhe nga ekspertiza e datës 21.01.2019 e përpiluar nga ekspertët mjeko ligjor Dr. E. K. dhe Dr. N. K., po ashtu edhe nga plotësim ekspertiza e datës 21.01.2021, e përpiluar nga ekspertët Dr. E.K. , Dr. A. B. dhe Dr. N. K., prandaj për Gjykatën nuk ka ndonjë dilemë lidhur me lëndimet e të dëmtuarit pasi që edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor është dëgjuar edhe ekspertja mjeko ligjore Dr. E. K..

Po ashtu gjykata ka refuzuar edhe propozimin e mbrojtësit të akuzuarit J. N., av.Muharrem Hadri, që gjykata të ftoj edhe ekspertet mjeko ligjor Dr.A. B. dhe Dr.N. K., që të iu mundësohet e drejta për të iu parashtruar pyetje lidhur me ekspertizën, pasi që lidhur me këtë ekspertizë është dëgjuar ekspertja mjeko ligjore Dr. E. K. dhe se dëgjimi i ekspertëve tjerë është i panevojshëm dhe konsiderohet si prolongim i procedurës, pasi që Gjykata konstaton se lidhur me lëndimet e të dëmtuarit U.Q. është vërtetuar mjaftueshëm nga Ekspertizat e cekura më lartë si dhe nga plotësim ekspertiza e Dr.F. B. e dt.16.03.2018.

6. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, pas administrimit të gjitha provave gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari J. N. me dashje kanë kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.3 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivi të këtij aktgjykimi.

7. Vendimet e trupit gjykues

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, trupit gjykues gjatë caktimit dhe shqiptimit të dënimit, ka vendosur që veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 KPRK-së (Kodi i vjetër nr.04/L-082) për të cilën akuzohet J. N., ta ri kualifikoj në veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.3 të KPRK-së (sipas Kodi të ri nr.06/L-74), këtë duke u bazuar në nenin 360 par.2 të KPP-së, ngase me këtë dispozitë është përcaktuar se “*Gjykatën nuk e detyrojnë propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale*” lidhur me nenin 3 par.1 dhe par.2 të KPRK-së, ku thuhet se “*par.1. ndaj kryerësit zbatohet*

ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale; par.2. Në rast se ligji në fuqi ndryshohet para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryerësit zbatohet ligji që është më i favorshëm". Gjykata bazuar në këtë dispozitë ligjore ka zbatuar kodin penal numër 06/L-074, i cili është më i favorshëm për të dënuarin, pasi që me këtë Kod penal, për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.3 të KPRK-së, parashihet dënim me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet, ndërsa kodi penal numër 04/L-82, është më i pafavorshëm për të akuzuarin, pasi që me këtë kod, për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 të KPRK-së, kryerësi dënohet me jo me pak se tre (3) vite burgim.

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, trupi gjykues të akuzuarin J. N., e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 nën par.1.3 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

8. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit me rastin e matjes së dënimit, trupi gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana rënduese dhe lehtësuese. Si rrethana rënduese për të akuzuarin J. N., i ka marrë për bazë këto rrethana shkallën e dëmit të shkaktuar të dëmtuarit i cili ka pasoja. Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për J. vetëm me nenën, i pa punë, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, sjellja e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekte qytetar i rëndomtë dhe se asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin nuk ka qenë i dënuar për vepër penale, i moshës relativisht i ri, po ashtu kontributin e viktimës para kryerjes së veprës penale. Prandaj duke marrë për bazë të gjitha këto gjykata ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe se ky dënim si i tilla i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojnë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehin gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

9. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 lidhur me par.1 të KPP-së.

10. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i Krimeve të Rënda -
PKR.nr.24/18, me datë 16.07.2021

Bashkëpunëtori profesional,
Driton Sadiku

Kryetari i Trupit Gjykses
Gjykatësi
Drilon Haraçia

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.